



Universiteti "Fan S. Noli"
FAKULTETI I EKONOMISË

FAKULTETI I EKONOMISË

RAPORT

I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM
PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË

VITI AKADEMIK 2018-2019

GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

- | | |
|---------------------------------|---------------|
| 1. Msc. Aida Mosko | Staf akademik |
| 2. Prof.as.dr. Oriola Theodhori | Staf akademik |
| 3. Doc.Dr.Marinela Teneqexhi | Staf akademik |
| 4. Edisnajda Shaholli | Studente |

Aida Mosko
Oriola Theodhori
Marinela Teneqexhi
Edisnajda Shaholli



FAKULTETI I EKONOMISË

RAPORT

I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË

VITI AKADEMIK 2018-2019

GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

- | | | |
|---------------------------------|---------------|-------|
| 1. Msc. Aida Mosko | Staf akademik | _____ |
| 2. Prof.as.dr. Oriola Theodhori | Staf akademik | _____ |
| 3. Doc.Dr.Marinela Teneqexhi | Staf akademik | _____ |
| 4. Edisnajda Shaholli | Studente | _____ |

Përmbajtja

HYRJE	1
PROGRAMI/ET E STUDIMEVE, MISIONI, ADMINISTRIMI	3
1. Misioni dhe Objektivat e programeve të studimit.....	3
2. Struktura akademike e Fakultetit /Departamentit (përgjegjës për programin/et e studimit)	11
3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për programet e studimit	13
4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit	22
5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare.....	25
6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programeve të studimit	28
POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE	31
7. Programet e studimit, organizimi i tyre.....	31
8. Mësimdhënia	50
9. Studentët	56
KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....	61
10. Kërkimi shkencor në funksion të programeve të studimit.....	61
11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun	63
ANALIZA SWOT	64

Lista e shkurtimeve

APAAL	Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
BCH	Bachelor
DNP	Diplomë e Nivelit të Parë
FE	Fakulteti i Ekonomisë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
IT	Teknologji dhe informacion
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimit
LAL	Ligji për Arsimin e Lartë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MP	Master Profesional
MSH	Master Shkencor
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PAE	Personel akademik efektiv
PAK	Personel akademik me kontratë
PA	Personel administrativ
UNIKO	Universiteti i Korçës

Lista e tabelave

Tabela 1 Programet e studimit 2018-2019	5
Tabela 2 Programet e studimit dhe data e licensimit	7
Tabela 3 Numri i stafit, 2018-2019.....	11
Tabela 4 Shpërndarja e stafit administrativ	12
Tabela 5 Cilësia e stafit akademik	12
Tabela 6 Personel Akademik Efektiv (PAE); Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA) ...	13
Tabela 7 Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Departamenti Financë-Kontabilitet	14
Tabela 8 Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Departamenti Menaxhim	15
Tabela 9 Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Departamenti Marketing-Turizëm	15
Tabela 10 Lëndët/modulet që janë mbuluar nga pedagogët e FE, sipas semestrave	16
Tabela 11 Mjediset e Fakultetit të Ekonomisë	22
Tabela 12 Mjediset për stafin	23
Tabela 13 Shpenzimet UNIKO për vitin 2018	26
Tabela 14 Programet e studimit dhe lëndët sipas tipit të veprimtarisë	32
Tabela 15 Struktura e programit të studimit BCH në Financë-Kontabilitet	33
Tabela 16 Struktura e programit të studimit BCH në Menaxhim	33
Tabela 17 Struktura e programit të studimit BCH në Administrim Biznesi në Marketing	33
Tabela 18 Struktura e programit të studimit BCH në Administrim Biznesi në Turizëm	33
Tabela 19 Struktura e programit të studimit BCH në Ekonomiks	33
Tabela 20 Struktura e programit të studimit BCH në Informatikë Biznesi	34
Tabela 21 Struktura e programit të studimit BCH në Biznes dhe Tregëti	34
Tabela 22 Struktura e programit të studimit MP në Financë-Kontabilitet (90 ECTS)	34
Tabela 23 Struktura e programit të studimit MP në Administrim Biznesi (90 ECTS)	34
Tabela 24 Struktura e programit të studimit MP në Marketing (90 ECTS)	35
Tabela 25 Struktura e programit të studimit MP në Turizëm (90 ECTS).....	35
Tabela 26 Struktura e programit të studimit MP në Financë-Kontabilitet (60 ECTS)	35
Tabela 27 Struktura e programit të studimit MP në Administrim Biznesi (60 ECTS)	35
Tabela 28 Struktura e programit të studimit MP në Marketing (60 ECTS)	36
Tabela 29 Struktura e programit të studimit MP në Turizëm (60 ECTS).....	36
Tabela 30 Struktura e programit të studimit MP në Bankë dhe Sigurime (60 ECTS).....	36
Tabela 31 Struktura e programit të studimit MSH në Financë	36

Tabela 32 Struktura e programit profesional 2-vjeçar "Asistent Menaxher"	37
Tabela 33 Diplomat sipas cikleve dhe programeve të studimit.....	37
Tabela 34 Shembull i formatit të tabelës për detajimin e planit mësimor të programit të studimit	39
Tabela 35 Struktura e planit mësimor: Programi Biznes dhe Tregëti	40
Tabela 36 Plani mësimor i programit "Biznes dhe Tregëti"	41
Tabela 37 Ngarkesa totale në auditor - BCH. Financë-Kontabilitet	51
Tabela 38 Ngarkesa totale në auditor - BCH në Menaxhim.....	51
Tabela 39 Ngarkesa totale në auditor - BCH në A.B. Marketing.....	52
Tabela 40 Ngarkesa totale në auditor - BCH në A.B. në Turizëm	52
Tabela 41 Ngarkesa totale në auditor - BCH në Ekonomiks	52
Tabela 42 Ngarkesa totale në auditor - BCH në Informatikë Biznesi	53
Tabela 43 Ngarkesa totale në auditor - BCH në Biznes dhe Tregëti	53
Tabela 44 Ngarkesa totale në auditor - MP në Financë-Kontabilitet.....	53
Tabela 45 Ngarkesa totale në auditor - MP në Administrim Biznesi	54
Tabela 46 Ngarkesa totale në auditor - MP në Marketing.....	54
Tabela 47 Ngarkesa totale në auditor - MP në Turizëm	55
Tabela 48 Ngarkesa totale në auditor - MP në Bankë dhe Sigurime	55
Tabela 49 Ngarkesa totale në auditor - MSH në Financë	56
Tabela 50 Numri i studentëve në vitin e parë në FE, 2018-2019.....	57
Tabela 51 Numri i studentëve për të gjitha programet e studimit, 2018-2019.....	58
Tabela 52 Numri i pjesëmarrësve në veprimtari shkencore dhe botuese, 2018-2019.....	62

HYRJE

Raporti i vlerësimit të brendshëm të Fakultetit të Ekonomisë paraqet rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti “Fan S. Noli” në Korçë për vitin akademik 2018-2019.

Ky raport u përgatit nga grupi i vlerësimit të brendshëm me qëllim sigurimin e një vlerësimi korrekt të nivelit të arritjes së standardeve të cilësisë në programet e studimit që janë objekt i këtij raporti duke shërbyer njëkohësisht si një material mbështetës për hartimin e raporteve të vlerësimit brendshëm për programet e studimit të cilat janë/do të jenë në procesin e akreditimit.

Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVB, krahas përvojës së fituar nga vlerësimet e mëparshme, ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit. Grupi i punës i ngritur për vlerësimin e brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Ekonomisë përbëhet nga pedagogët: Doc. Dr. MarinelaTeneqexhi; Prof. As. Dr. Oriola Theodhori; Dr. Aida Mosko respektivisht me eksperiencë 10, 10 dhe 4 vjeçare. Ai ka qënë pjesë e trajnimeve të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit. Për të realizuar këtë raport GVB hartoi kalendarin e aktiviteteve për të siguruar të dhënat dhe informacionin e nevojshëm. Gjatë punës grupi i vetvlerësimit ka pasur kontakte të vazhdueshme me: anëtarët e tjerë të grupeve të vlerësimit të brendshëm në fakultetet e tjera; Rektoratin e Universitetit, Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, përgjegjësat e departamenteve, stafin e pedagoqeve si dhe stafin ndihmës-mësuesor.

Vlerësimi i programeve të studimit u realizua duke u bazuar në standartet. Duhet të theksojmë se, studimet sipas kriterëve të Kartës së Bolonjës në Fakultetin e Ekonomisë filluan në vitin akademik 2005-2006. Paraprakisht u krijua një grup pune për ristrukturimin e planeve dhe programeve mësimore, në bashkëpunim edhe me Fakultetin e Ekonomisë të universitetit të Tiranës. Në Qershor 2006 filloi dhe procesi i vetvlerësimit të Fakultetit të Ekonomisë në bazë të udhëzimeve të Agjencisë Kombëtare të Akreditimit. Pasi u realizua vlerësimi i brendshëm i cilësisë nëpërmjet hartimit të raportit të vetvlerësimit u realizua edhe vlerësimi i jashtëm i Fakultetit të Ekonomisë, i cili u pasqyrua në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Qëllimi i këtij raporti është që të sigurojë një vlerësim të programeve të studimit bazuar në tregues realë dhe të matshëm për vitin akademik 2018-2019. Për hartimin e këtij raporti, GVB mbajti parasysh edhe raportin e GVJ që u realizua në kuadër të akreditimit institucional si edhe raportin e mëparshëm të vetvlerësimit. Gjithashtu u shfytëzuan të gjitha materialet, të dhënat e Fakultetit, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën. Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Ekonomisë përfshin:

Ligjin nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.

- Standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve.
- Raportin e Vlerësimit Institucional të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë Prill 2017.
- Analizën e e punës mësimore–shkencore të Fakultetit të Ekonomisë për vitin 2018-2019
- Udhëzimet e MASR-së.
- Dokumentet mbështetëse të veprimtarisë institucionale të Universitetit "Fan S. Noli":
- Statutin dhe Rregulloren e UK-së
- Rregulloret e Programeve të studimit; rregulloret e transferimeve dhe rregulloret e praktikave mësimore dhe profesionale.
- Planet mësimore; Formularët e ngarkesës vjetore të stafit, etj.

Grupi I vlerësimit të brendshëm përbëhet nga:

- | | |
|---------------------------------|---|
| 1. Dr. Aida Mosko | Kryetare; Departamenti Financë-Konbatilitet |
| 2. Prof.as.dr. Oriola Theodhori | Anëtare; Departamenti Marketing-Turizëm |
| 3. Doc.Dr.Marinela Teneqexhi | Anëtare; Departamenti Menaxhim |
| 4. Edisnajda Shaholli | Anëtare; Studente Dega Financë-Kontabilitet |

PROGRAMI/ET E STUDIMEVE, MISIONI, ADMINISTRIMI

Skeda Informative

Fakulteti	Fakulteti i Ekonomisë
Adresa:	Shëtitorja "Rilindasit" Korçë
E-mail	rektorati@yahoo.com
Liçensuar	VKM, nr. 5, dt. 7 janar 1992
Statusi aktual ligjor	I akredituar
Përfaqësuesi zyrtar	Prof.as.dr.Frederik Çuçllari Tel.++ 355 82242201
	Dekan
	e-mail: fcucllari@unkorce.edu.al
	fcucllari@gmail.com
Struktura akademike	Departamenti Financë-Kontabilitet
	Departamenti i Menaxhimit
	Departamenti Marketing-Turizëm
Oferta Akademike:	Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor) (Niveli 6 KSHK)
	Cikli i Dytë i Studimeve (Master i Shkencave, Master Profesional) (Niveli 7 KSHK)

1. Misioni dhe Objektivat e programeve të studimit

Aktualisht, fakulteti i Ekonomisë operon mbi bazën e programeve të reja mësimore, në përputhje me programet e shkollave perëndimore, bazuar në deklaratën e Bolonjës dhe të përshtatura ndaj kushteve aktuale të vendit tonë.

Stafi i fakultetit punon për të përmirësuar vazhdimisht raportet dhe standartet që kërkon kjo deklaratë. Krahas angazhimit për një mësimdhënie cilësore, personeli i fakultetit është i angazhuar në një punë studimore-shkencore e botuese, në funksion të procesit mësimor, duke dhënë njëkohësisht kontribut profesional në fushat e financë- kontabilitetit, menaxhimit, marketingut dhe turizmit.

Mbi bazën e eksperiencës së fituar janë hartuar programet mësimore për të gjitha nielet në përputhje me kërkesat që shtrihen për përgatitjen e specialistëve, sipas kërkesave të tregut.

Gjithashtu Fakulteti i Ekonomisë jep kontributin e tij shkencor e profesional në fusha e sektorë të ndryshëm të ekonomisë e biznesit në rajon dhe më gjerë.

Një kontribut i vlerësuar është në fushën e kërkimeve shkencore në formën e artikujve, monografive, referimeve në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.

Të gjitha përditësimet e programeve të studimit në Fakultetin e Ekonomisë, marrin parasysh përvojën më të mirë në nivel kombëtar, si dhe tendencat e zhvillimeve më të fundit europiane.

Objektivat e vendosura për vitin 2018-2019:

- a. Rritja e nivelit të mësimdhënies dhe e të nxënit.
- b. Përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave me literaturë bashkëkohore.
- c. Kualifikimi i pedagogëve përmes formave të ndryshme të kualifikimit (si individuale ashtu edhe ato të organizuara apo të mbështetura nga Fakulteti).
- d. Pjesëmarrja në projekte duke synuar rritjen e cilësisë së punës në Fakultet.
- e. Rritja e bashkëpunimit me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës si dhe me Fakultete të tjera ekonomike brenda dhe jashtë vendit.
- f. Këto janë objektivat e përgjithshme, por Departamentet në varësi të prioritetëve kanë vendosur edhe objektiva të veçanta, realizimi i të cilave është pasqyruar në raportet e secilit Departament.

Programet e studimit

Gjatë vitit akademik 2018-2019 fakulteti i Ekonomisë ka filluar ofrimin e studimeve në **një Program Professional 2- vjeçar**, i cili mbulohet nga Departamenti i Menaxhimit, konkretisht në programin

1. Asistent Menaxher.

Fakulteti i Ekonomisë në **ciklin e parë të studimeve**, sistemi me kohë të plotë, ofron **7 programe** studimi të cilat vazhdimisht rifreskohen duke pasqyruar zhvillimet më të fundit në fushën akademike, kryesisht të universiteteve europiane.

Programe ekzistuese:

1. Financë-Kontabilitet
2. Menaxhim
3. Administrim Biznesi në Marketing
4. Administrim Biznesi në Turizëm

Programe të reja studimi të çelura për herë të parë gjatë këtij viti akademik

5. Informatikë Biznesi, i cili mbulohet nga Departamenti i Menaxhimit
6. Ekonomiks, i cili mbulohet nga Departamenti Financë-Kontabilitet
7. Biznes dhe Tregti, i cili mbulohet nga Departamenti Marketing-Turizëm

Në *ciklin e dytë të studimeve*, sistemi me kohë të plotë, janë ofruar 5 programe studimi Master Profesional dhe një program studimi Master i shkencave. Një prej programeve të studimit Master Profesional, ai në Bankë dhe Sigurime filloi për herë të parë këtë vit akademik. Ky program mbulohet nga Departamenti Financë - Kontabilitet.

Programe ekzistuese Master Profesional në:

1. Financë-Kontabilitet
2. Administrim Biznesi
3. Marketing
4. Turizëm

Program i ri studimi (filluar ky vit akademik, 2018-2019)

5. Bankë dhe Sigurime

Studentët me rezultate më të larta ndjekin studimet në programin Master i Shkencave në Financë. Ky program ka vazhduar edhe për vitin akademik 2018-2019.

Në Tabela 1 Programet e studimit 2018-2019 paraqiten të përmbledhura programet e studimit që janë ofruar gjatë periudhës raportuese

Tabela 1 Programet e studimit 2018-2019

Nr.	BA/ MP/MSc/ PP	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Ekzistues/ Çelur 2018-2019
1	Bachelor	1. Financë-Kontabilitet	Ekzistues
2		2. Ekonomiks	2018-2019
3		3. Menaxhim	Ekzistues
4		4. Informatikë Biznesi	2018-2019
5		5. Administrim Biznesi në Marketing	Ekzistues
6		6. Administrim Biznesi në Turizëm	Ekzistues
7		7. Biznes dhe Tregti	2018-2019

8	Master Profesional	1. Financë-Kontabilitet (60 dhe 90 kredite)	Ekzistues
9		2. Bankë dhe Sigurime	2018-2019
10		3. Administrim Biznesi (60 dhe 90 kredite)	Ekzistues
11		4. Marketing	Ekzistues
12		5. Turizëm	Ekzistues
13	Master i Shkencave	6. Financë	Ekzistues
14	Program Profesional	1. Asistent Menaxher	2018-2019

Misioni

“Fakulteti i Ekonomisë iu ofron studentëve kushte për edukimin e tyre në përputhje me sfidat e Integritimit Europian për të formuar dhe përgatitur specialistët e ardhshëm që t’i përshtaten situatave konkurruese të tregut në zgjidhjen e problemeve ekonomike nëpërmjet zhvillimit dhe transmetimit të dijeve me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor”.

Përmbushja e këtij misioni do të realizohet përmes këtyre objektivave:

- Të ofrojë njohuri bazë shkencore-teorike, bashkëkohore në fushën e ekonomisë.
- Të ofrojë njohuri praktike për t’iu përshtatur sa më mirë dhe sa më shpejt, detyrave konkrete në vendet e punës.
- Të rritë aftësitë teorike dhe praktike duke bërë profilizimin profesional.
- Të krijojë mundësi për kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të rinj në fushën e ekonomisë.
- Të forcojë lidhjet dhe shkëmbimet me fakultetet e tjera homologe brenda dhe jashtë vendit.
- Të luajë një rol aktiv si pjesëmarrës në projekte kërkim-zhvillimi duke ju përgjigjur perspektivës së zhvillimit të Rajonit.

Vizioni

“Vizioni i Fakultetit është të jemi zgjedhja e studentëve cilësorë të Rajonit Juglindor dhe më gjerë duke garantuar një mjedis atraktiv në të cilin çdo student mund të jetë i suksesshëm. Ne besojmë se angazhimi i studentëve është shumë i rëndësishëm për suksesin e tyre”.

Në tabelën e mëposhtme, Tabela 2 Programet e studimit dhe data e licensimit, paraqiten në mënyrë të përmbledhur programet e studimit që ofrohen nga fakulteti i Ekonomisë, statusi i tyre dhe data e aktit të hapjes së tyre.

Tabela 2 Programet e studimit dhe data e licensimit

N..	BA/ MP/MSc/ PP	EMËRTIMI I PROGRAMIT	STATUSI	DATA E AKTIT TË HAPJE	Nr.
1.	BA	Financë-Kontabilitet	Aktiv	Hapur më 04.08.1998	Vendim Nr. 142
2.	BA	Ekonomiks	Aktiv	Hapur më 27.07.2018	Urdhër Nr. 467
3.	BA	Menaxhim	Aktiv	Hapur më 29. 05.	1992Vendim Nr. 230
4.	BA	Informatikë Biznesi	Aktiv	Hapur më 12. 07.	2018Urdhër Nr. 402
5.	BA	Administrim Biznesi në Marketing	Aktiv	Hapur më 29.05.1992 Riorganizuar më 03.06.2013	Vendim Nr. 230 Vendim Nr. 499
6.	BA	Administrim Biznesi në Turizëm	Aktiv	Hapur më 29.05.1992 Riorganizuar më 03.06.2013	Vendim Nr. 230 Vendim Nr. 499
7.	BA	Biznes dhe Tregti	Aktiv	Hapur më 09.07.2018	Urdhër Nr. 386
8.	MP ^(90 kredite)	Financë-Kontabilitet	Aktiv	Hapur më 14.09.2011	Vendim Nr. 672
9.	MP ^(60 kredite)	Financë-Kontabilitet	Aktiv	Riorganizuar më 01.10.2018	Vendim Nr. 575
10.	MP	Bankë dhe Sigurime	Aktiv	Hapur më 10.07.	2018Urdhër Nr. 388
11.	MP ^(90 kredite)	Administrim Biznesi	Aktiv	Hapur më 23. 11. 2011	Vendim Nr. 565
12.	MP ^(60 kredite)	Administrim Biznesi	Aktiv	Riorganizuar më 01. 10. 2018	Vendim Nr. 575
13.	MP ^(90 kredite)	Marketing	Aktiv	Hapur më 23.11.2011	Vendim Nr. 565
14.	MP ^(60 kredite)	Marketing	Aktiv	Riorganizuar më 01. 10. 2018	Vendim Nr. 575
15.	MP ^(90 kredite)	Turizëm	Aktiv	Hapur më 23.11.2011	Vendim Nr. 565
16.	MP ^(60 kredite)	Turizëm	Aktiv	Riorganizuar më 01. 10. 2018	Vendim Nr. 575
17.	MSc	Financë	Aktiv	Hapur më 20.11.2012	Vendim Nr. 575
18.	PP	Asistent Menaxher	Aktiv	Hapur më 05. 07. 2018	Urdhër Nr. 370

Vlerësimi sipas Standardeve

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT
Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimit kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programeve të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programeve</p> <p>Kriteri 5 përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit</p>	<p>Të gjitha programet e studimit që ofron Fakulteti i Ekonomisë janë në përputhje me misionin dhe vizionin e UK, si edhe me strategjinë për zhvillimin e FE. Në rregulloret e këtyre programve është e dukshme lidhja e me qëllimet, misionin e institucionit si edhe me fushën e veprimtarisë së shprehur në Planin Strategjik 2016-2020 të FE.</p> <p>Në rregulloret e programeve të studimit përcaktohet qartë qëllimi dhe misioni^{1,2} i tij si edhe njohuritë teorike dhe praktike që transmetohen prej tyre tek studentët. Elementët që lidhen me tregun e punës dhe zhvillimin rajonal dhe kombëtar të vendit janë pjesë e formimit të studentëve për të bërë të mundur përballjen e tyre me sukses me sfidat e tregut të punës^{3,4}.</p> <p>Në koherencë me misionin e FE, programet e studimit kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Gjatë vitit 2018 - 2019 është punuar në drejtim të një bashkërendimi më të mirë midis departamenteve, veçanërisht për sa u takon subjekteve, të cilat zhvillohen në të gjitha programet e studimit. Rregulloret e programeve të studimit janë riparë, veçanërisht për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në</p>	

¹ Statuti UNIKO, Neni 1-2; Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020

² Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020

³ Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve

⁴ Shembull praktike e studimit të tregut të punës, programi i studimit “Finance”

përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të drejtimeve prioritare akademike të UK, të përcaktuara në <i>statutin</i> e UK ⁵ neni 6 pika 8 dhe referuar si fushë studimi në <i>Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë</i> .
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Programet përputhen më së miri me fushat strategjike të strategjisë së zhvillimit të institucionit. Fushat e studimit për këto programe, përkojnë me drejtimit e kërkimit shkencor në UNIKO ⁶ .
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programet e studimit synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit ^{7, 8}

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programet e studimit synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Fakulteti i Ekonomisë ofron programe studimi të cilat plotësojnë kërkesat e maturantëve për të vazhduar studimet në fushën e ekonomisë dhe nga ana tjetër stafi akademik plotëson ofertën e institucionit me programe studimi në financë, menaxhim, marketing dhe turizëm për përgatitjen e menaxherëve të ardhshëm në këtë drejtim në përputhje me ligjin për arsimin e lartë ⁹ .
Kriteri 2.	

⁵ Statuti UNIKO, Neni 1-2; Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020

⁶ <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor>

⁷ Rregulloret e programit të studimit sipas degëve

⁸ Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020

⁹ Ligji për arsimin e lartë në RSH

<p>Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <p>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</p> <p>b. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>Aktivitetet e Fakultetit të Ekonomisë në kuadrin e UNIKO-s si institucion i arsimit të lartë mbështetet në një pamje të hapur të bashkëpunimit dhe partneritetit me institucionet publike dhe private, në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar¹⁰. Kurrikula aktuale e programeve të studimit është vazhdimisht e ristrukturuar me qëllim rritjen e vlerës së diplomës së dhënë në tregun e punës. Janë parashikuar programe të reja dyvjeçare profesionale (profesionale) për të hapur me qëllim furnizimin e tregut me kualifikime praktike profesionale ^{11, 12, 13}</p>
<p>Standardi II.2 - Programet e studimit synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimit synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë plotësojnë kriteret e këtij standardi¹⁴</p>
<p>Konkluzione të GVB: Programet e studimit që ofrohen nga Fakulteti i Ekonomisë janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universitetit në afat të gjatë dhe kërkesat aktuale të tregut për të përgatitur menaxherë t'ë aftë në specialitetet përkatëse.</p>	

¹⁰ <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor> (Bashkëpunime, marreveshjet)

¹¹ VKM Nr. 514, dt. datë 20.9.2017 “PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR”
https://www.google.com/search?q=Lista+kombetare+e+profesioneve&rlz=1C1CHBF_enAL819AL819&oq=Lista+kombetare+e+profesioneve&aqs=chrome..69i57j69i60l2.6387j0j7&sourceid=chrome&ie=UTF-8

¹² Rregullore e programit profesional “Asistent menaxher”

¹³ Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Harta strategjike, A.1. – A.3; fq. 19)


¹⁴ Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve-Objektivat formuese

2. Struktura akademike e Fakultetit /Departamentit (përgjegjës për programin/et e studimit)

Fakulteti i Ekonomisë në vitin 2018-2019 ka efektivisht 39 punonjes, prej të cilëve 34 punonjës mësimorë dhe 5 ndihmës mësimorë. Pozicionet Dekan dhe Përgjegjës Departamenti janë të përfshirë brenda numrit të punonjësve të Departamenteve përkatëse. Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga tre departamente:

1. Departamenti Financë-Kontabilitetit
2. Departamenti i Menaxhimit
3. Departamenti Marketing-Turizmëm

Struktura organizacionale e Fakultetit të Ekonomisë jepet në organogramën në vijim.



Numri i miratuar i punonjësve në FE është **45**. Fakulteti i Ekonomisë ka pasur gjatë vitit 2019 efektivisht **41** (33 + 8) punonjës mësimorë (si në tabelën Tabela 3 Numri i stafit, 2018-2019) dhe ndihmësmësimorë. Pozicionet Dekan dhe Përgjegjës Departamenti kanë qenë të përfshirë brenda numrit të punonjësve të Departamenteve përkatëse.

Fakulteti i Ekonomisë ka sekretarinë e tij mësimore me dy punonjëse: 1 (një) kryesekretare dhe 1 (një) sekretare; 1 (një) asistente e dekanit, 2 (dy) punonjëse staf mbështetës për Departamentet, 1 (një) punonjës në bibliotekë (si në tabelën Tabela 4 Shpërndarja e stafit administrativ), si dhe 2 (dy) punonjëse shërbimi.

Tabela 3 Numri i stafit, 2018-2019

Staf drejtues	Staf akademik (+ stafi drejtues)	Stafi administrativ
4	33	8

Tabela 4 Shpërndarja e stafit administrativ

Nr	Njësia administrative	Nr.punonjës
1	Ndihmësja e Dekanit	1
2	Sekretaria mësimore	4
3	Zyra e informimit dhe orientimit të studentëve	-
4	Biblioteka	1
5	Punonjës shërbimi	2

Tregues të matshëm në lidhje me cilësinë e stafit akademik

Fakulteti i Ekonomisë aktualisht ka një staf akademik të kualifikuar, që përbëhet nga 14 profesorë të asociuar, 13 doktorë, 4 studentë doktore dhe 2 MSc. Në mënyrë të detajuar sipas çdo departamenti dhe në total këto të dhëna paraqiten tek Tabela 5 Cilësia e stafit akademik.

Tabela 5 Cilësia e stafit akademik

KUALIFIKIMI	DEPARTAMENTI FINANCË- KONTABILITET		DEPARTAMENTI MENAXHIM		DEPARTAMENTI MARKETING -TURIZËM		TOTAL	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
TITUJ	5	38%	4	40%	5	50%	14	42%
GRADA	5	38%	4	40%	4	40%	13	40%
DOKTORANTË	2	15%	1	10%	1	10%	4	12%
MSc	1	8%	1	10%	-	-	2	6%
MP	-	-	-	-	-	-	-	-
BA	-	-	-	-	-	-	-	-
PA TITUJ DHE GRADA		23%		20%		10%		18%

Stafi i kualifikuar me grada dhe tituj në nivel Fakulteti përbën rreth 82% të totalit, përkatësisht:

Departamenti Financë - Kontabilitet → 77%,

Departamenti Menaxhim → 80%,

Departamenti Marketing - Turizëm → 90%.

Numri i Personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat si në tabelën Tabela 6 Personel Akademik Efektiv (PAE); Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA).

Tabela 6 Personel Akademik Efektiv (PAE); Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA)

Fakulteti i Ekonomisë	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Total (a)+(b)+(c)
	Gjithsej (a)	Tituj/Grada	Gjithsej (a)	Tituj/Grada	Gjithsej (a)	Tituj/Grada	
Financë-Kontabilitet	14	10	1	-	1	-	15
Menaxhim	10	8	2	-	-	-	12
Marketing-Turizëm	10	9	-	-	-	-	6
Fakulteti	-	-	-	-	6	-	6
TOTAL	34	27	5	3	8	-	44

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për programet e studimit

Raporti midis stafit mësimdhënës dhe numrit të studentëve për Fakultetin e Ekonomisë, Niveli Bachelor për vitin akademik 2018-2019 është rreth 1/18, kurse në programet e ciklit të dytë “Master” raporti staf/student është rreth 1/7. Mbulimi i orëve për vitin në raportim është kryer në masën 88 % me pedagogë të brendshëm dhe 12% me pedagogë të ftuar¹⁵.

Raporti staf i kualifikuar, staf i pakualifikuar është 82 % staf i kualifikuar dhe 12% në proces doktorature dhe 6% staf i pakualifikuar. Raporti staf i brendshëm, staf i jashtëm. 92 % / 8%.¹⁶.

Punonjësit e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit pranohen me konkurim publik. Kriteret specifike të konkurrimit për të dyja kategoritë propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani. Këto kriteret i përcillen Rektorit për miratim nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Për zhvillimin e konkursit Dekani i Fakultetit ngre një komision të përbërë nga përfaqësues të Departamentit, të Fakultetit dhe të Universitetit. Në komision, marrin pjesë Zv/Rektori, Përgjegjësi i Degës së Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjësi i Departamentit. Komisioni harton dhe i paraqet Rektorit për miratim pikët e vlerësimit për çdo kriter të veçantë. Rektori bën shpalljet përkatëse. Konkursi zhvillohet në afatet e përcaktuara sipas rregullave në fuqi. Kandidatët e përzgjedhur, me përjashtim të kategorisë “Profesorë” (Profesorëve dhe Profesorëve të Asociuar), merren me kontratë njëvjeçare, mbështetur në ligjin “Për Arsimin e Lartë në RSH”, i ndryshuar dhe në Kodin e Punës të

¹⁵ Mbështetur në të dhënat e Tabela 3 Numri i stafit, 2018-2019 dhe Tabela 51 Numri i studentëve për të gjitha programet e studimit, 2018-2019

¹⁶ Mbështetur në të dhënat e Tabela 5 Cilësia e stafit akademik dhe Tabela 6 Personel Akademik Efektiv (PAE); Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA)

Republikës së Shqipërisë. Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimin e personelit akademik, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 47 të ligjit të mësipërm. Kontrata nënshkruhet nga i punësuar dhe Rektori. Pas përfundimit të kontratës dhe plotësimit të kushteve të saj, për punonjësit me gradë shkencore, kontrata mund të kthehet në definitive. Punonjësit pa gradë shkencore mund të merren vetëm me kontratë të përsëritshme deri në 3 vjet. Pedagogët e ftuar, pasi rezultojnë fitues në konkurs, merren me kontratë njëvjeçare. Punonjësit akademikë të ftuar propozohen nga departamenti në bazë të nevojave të tyre dhe miratohen nga dekani i fakultetit dhe Rektori i Universitetit.

Punonjësit mësimorë të huaj pranohen në procesin mësimor me propozim të dekanit dhe vendim të Senatit të Universitetit. Në përfundim të procedurave të rekrutimit të stafit të ri akademik, materialet informative (njoftimet për punë), dosjet e plota të kandidatëve që kanë aplikuar dhe atyre që janë shpallur fitues, vendimet e marra nga komisionet e fakulteteve dhe vendimet e Senatit depozitohen të gjitha pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Universitet. Pedagogët e brendshëm dhe të ftuar përzgjidhen në bazë të dosjes individuale të aplikimit (dokumentacionit të kualifikimeve profesionale). Për përzgjedhjen e kandidatëve vendos Rektori (që ka edhe cilësinë e punëdhënësit), i cili mund të tërheqë sipas rastit mendimin e Dekanit të Fakultetit apo Përgjegjësit të Departamentit, ku kandidati aplikon. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti për të cilin aplikon kandidati, në përputhje me legjislacionin në fuqi për Arsimin e Lartë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Pedagogët e huaj pranohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe. Dosjet e personelit akademik të brendshëm dhe administrativ kanë në përbërje dokumentacionin e mëposhtëm: Dokumentin e identitetit (fotokopje e pasaportës ose kartës së identitetit). Dokumentin që vërteton punën e kryer më parë (librezë pune ose vërtetim nga punëdhënësi i mëparshëm). Librezën e sigurimit shoqëror e shëndetësor. Diplomën e shkollës së lartë dhe listën e notave. Kualifikimet e tjera profesionale (brenda ose jashtë vendit). Gradat shkencore apo titujt akademikë. Raportin mjekësor për aftësimin në punë ose librezën shëndetësore, lëshuar nga inspektoriati sanitar shtetëror endbanimit ose ndonjë dokument tjetër të nevojshëm, sipas specifikës së vendit të punës. E gjithë procedura pasqyrohet në statutin e UNIKO. (Të gjitha këto të dhëna gjenden tek Zyra e Byrimeve Njerëzore të Universitetit).

Tabela 7 Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Departamenti Financë-Kontabilitet

Nr.	Personeli Akademik Efektiv	Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	Nr.	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli/ Grada	Institucioni ku punon full time
-----	----------------------------	----------------	----------------	-----	---	----------------	---------------------------------

	(Emër Mbiemër)						
1	Anila Mancka	Përgjegjës	Prof.As	1	Igli Stratoberdha	Msc	
2	Frederik Çuçllari	Dekan	Prof.As				
3	Majlinda Bello	Zv.Rektore	Prof.As				
4	Alketa Zheku	Pedagog	Prof.As				
5	Konstandin Nasto	Pedagog	Dr				
6	Eleni Vangjeli	Pedagog	Prof.As				
7	Klaudeta Merollari	Pedagog	Dr				
8	Klaudia Lipi	Pedagog	Dr				
9	Sorina Koti	Pedagog	Dr				
10	Genci Gjançi	Pedagog	Dr				
11	Junada Sulillari	Pedagog	Msc				
12	Marsida Harremi	Pedagog	Dr				
13	Jorida Koçibelli	Pedagog	Msc				
14	Aida Mosko	Pedagog	Msc				

Tabela 8 Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Departamenti Menaxhim

Nr.	Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	Nr.	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli/ Grada	Institucioni ku punon full time
1	Suela Gërdhe	Përgjegjës	Prof.As	1	Krisula Koça	Msc.	
2	Mirela Çuçllari	Pedagog	Prof.As	2	Dhimitraq Zonja	Msc.	
3	Sonela Stillo	Pedagog	Prof.As				
4	Aida Gabeta	Pedagog	Prof.As				
5	Marinela Teneqexhi	Pedagog	Doc.Dr				
6	Eva Dhimitri	Pedagog	Dr				
7	Elda Dollija	Pedagog	Dr				
8	Emil Frasherri	Pedagog	Dr				
9	Iva Pendavinji	Pedagog	Msc.				
10	Gentisa Furxhi	Pedagog	Msc.				

Tabela 9 Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Departamenti Marketing-Turizëm

Nr.	Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	Nr.	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli/ Grada	Institucioni ku punon full time
1	Ledina Alolli	Përgjegjës	Prof.As	1	Fatmir Mema	Prof.Dr.	FE Tiranë
2	Eleina Qirici	Pedagog	Prof.As				
3	Esmeralda Shkira	Pedagog	Prof.As				

4	Oriola Theodhori	Pedagog	Prof.As			
5	Mamica Nene	Pedagog	Dr			
6	Dr. Alma Zhilla	Pedagog	Prof.As			
7	Marenglena Hoxhaj	Pedagog	Dr			
8	Landi Gushi	Pedagog	Dr			
9	Denada Olli	Pedagog	Dr			
10	Erjon Nexhipi	Pedagog	Dr			

Tabela 10 Lëndët/modulet që janë mbuluar nga pedagogët e FE, sipas semestrave

Emërtimi i njësisë	Stafi Akademik	Ngarkesa mësimore		Lëndët/modulet	
		Norma	Realizimi	Semestri I	Semestri II
DEPARTAMENTI FINANCE-KONTABILITET	Prof.Asc.Dr. Frederik Çuçllari	70	277.5	- Kontabilitet financiar - Sistemi fiskal	- Financat ndërkombëtare - Kontabilitet
	Prof.Asc.Dr. Majlinda Bello	70	272.5	- Hyrje në ekonomi - Financë publike	- Financë publike - Fiskalitet
	Prof.Asc.Dr. Anila Mançka	90	285	- Analiza e pasqyrave financiare - Analiza e investimeve dhe menaxhimi i portofolit (Portofoli i investimeve)	- Investime
	Prof.Asc.Dr. Eleni Vangjeli	140	337	- Makroekonomi	- Mikroekonomi - Etika profesionale në kontabilitet
	Prof.Asc.Dr. Alketa Pasholli	140	284	- Kontabiliteti i avancuar - Auditimi në bankë dhe sigurime	- Kontabiliteti i kostos - Auditimi
	Dr. Klaudeta Merollari	165	322	- Kontabilitet drejtimi	- Tregje dhe institucione financiare - Kontabilitet drejtimi i avancuar - Legjislacion dhe mbikqyrje e tregut të sigurimeve
	Dr. Genci Gjançi	165	383	- Rregullimi bankar	- Drejtim bankar - Bankim qëndror - Standardet kombëtare të kontabilitetit
	Dr. Klaudia Lipi	165	380	- Drejtim i sigurimeve - Teoria dhe praktika e sigurimeve - Drejtimi i sigurimeve dhe fondet e pensionit	- Teknika bankare - Teori dhe modele të zhvillimit ekonomik

	Dr. Sorina Koti	165	335	- Drejtim financiar i organizatave publike - Sistemi monetar europian	- Drejtim financiar - Sistemi doganor
	Dr. Marsida Harremi	165 / 195	354	- Bazat e financës	- Shkrim akademik - Parashikimi dhe vlerësimi financiar
	MSc. Aida Mosko	195	280	- Kontabilitet publik - Kontabilitet aplikativ - Financë publike	- Vlerësimi i pasurive të paluajtshme
	MSc. Jorida Koçibelli	195	308	- Hyrje në ekonomi - Mikroekonomi I	- Politikat ekonomike - Ekonomi - Kontabiliteti i institucioneve dhe instrumenteve financiare
	MSc. Junada Sulillari	195	360	- Hyrje në ekonomi	- Mikroekonomi
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT	Prof.Asc.Dr. Suela Gerdhe	90	300	- Komunikimi në biznes - Sjellje organizative	- Sjellje organizative
	Prof.Asc.Dr. Mirela Cini	140	314	- Menaxhimi i projektit	- Menaxhimi i operacioneve - Marrja e vendimeve menaxheriale
	Prof.Asc.Dr. Sonela Stillo	140	340	- Qeverisja e korporatave - Menaxhimi i burimeve njerëzore	- Menaxhim biznesi
	Prof.Asc.Dr. Aida Gabeta	140	320	- Menaxhimi i cilësisë	- Sipërmarrja dhe menaxhimi i biznesit të vogël - Menaxhimi strategjik
	Dr. Marinela Teneqexhi	165	341	- Statistikë - MIS	- Statistikë - Menaxhimi i shpërblimit
	Dr. Eva Dhimitri	165	350	- Histori e ekonomisë - Lidërshipi	- Menaxhimi publik - Administrimi publik
	Dr. Elda Dollija	165	200	- Menaxhimi i riskut	- E-Biznes - Menaxhimi i performancës
	Dr. Emil Frashëri	165	289	- Statistikë - Komunikimi në biznes	- Statistikë - Ekonomiksi menaxherial - Ekonometri
	MSc. Gentisa Furxhi	195	283	- Etika profesionale - Menaxhimi i ndryshimit	- Etika në biznes - Biznesi ndërkombëtar
	MSc. Iva Pendavinji	195	380	- E drejtë civile - Edukim ligjor - Menaxhimi i arsimit dhe legjislacioni në arsimin para universitar	- E drejtë biznesi - Ligje për informaticienët e biznesit

	Prof.Asc.Dr. Ledina Alolli	90	310	- Sjellje konsumatore - Ekonomiksi integrimin europian	- Strategjia marketing dhe pozicionimi në treg - Menaxhimi marketing i biznesit
	Prof.Asc.Dr. Eleina Qirici	140	318	- Menaxhimi i ndërmarrjeve turistike - Tipe turizmi - Planifikimi	- Komunikimi integruar marketing
	Prof.Asc.Dr. Esmeralda Shkira	140	335	- Hyrje në turizëm / Industria e mikpritjes - Menaxhimi i marrëdhënieve me konsumatorët - Ekoturizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	- Strategji turizmi
DEPARTAMENTI MARKETING - TURIZEM	Prof.Asc.Dr. Oriola Theodhori	140	346	- Drejtim marketing - Menaxhimi strategjik i markës	- Marketingu në internet - Plani marketing
	Prof.Asc.Dr. Mamica Nene	140	345	- Bazat e marketingut - Marketingu i shërbimeve - Marketingu i shërbimeve financiare	- Cilësia totale në marketing
	Dr. Alma Zhilla	165	237	- Turizëm kulturor dhe trashëgimi kulturore	- Turizëm ndërkombëtar - Strategji turizmi - Prodhim shpërndarje e produktit turistik
	Dr. Marenglena Hoxhaj	195 / 165	300	- Marketing & strategji eksporti	- Marketing ndërkombëtar - Sociologji - Plan marketing
	Dr. Landi Gushi	195 / 165	382.5	- Planifikim social - Administrim social, sigurime shoqerore - Administrim social, sigurime shëndetësore	- Kërkim marketing - Vlerësimi i politikave sociale - Administrim social, shërbim social
	Dr. Denada Olli	195 / 165	401	- Legjislacion turistik - Marrëdhënie publike - Menaxhim ngjarjesh - Drejtim i operacioneve të ushqimit dhe pijes	- Cilësia shërbimeve turistike - Legjislacion turistik
	MSc. Erjon Nexhipi	195	420	- Bazat e marketingut - Excel për menaxherët marketing - Excel për menaxherët financiar - Kërkim marketing i thelluar	- Drejtim i kanaleve marketing - Menaxhimi i forcës shitëse - Marketingu politik

Tituj dhe grada të fituara gjatë vitit akademik 2018 - 2019

Në kuadër të kualifikimit shkencor pedagogët e Fakulteti të Ekonomisë janë përfshirë në procedurat për fitimin e titujve "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" si dhe për përfundimin e detyrimeve për marrjen e gradës shkencore "Doktor". Gjatë vitit 2018 -2019 ka pasur një angazhim maksimal të doktorantëve për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi, duke marrë gradën shkencore "Doktor":

Landi Gushi → Departamenti Marketing - Turizëm;

Marenglena Hoxhaj → Departamenti Marketing - Turizëm;

Denada Olli → Departamenti Marketing - Turizëm;

Marsida Harremi → Departamenti Financë - Kontabilitet.

Këshilli Shkencor i Programeve të studimit/Koordinatori/ët e programeve të studimit

Emër Mbiemër		Titulli/ grada	Departamenti
1.	Anila Mançka	Prof.as.dr.	Financë-Kontabilitet
2.	Klaudeta Merollari	Dr.	
3.	Klaudia Lipi	Dr.	
4.	Sorina Koti	Dr.	
5.	Jorida Koçibelli	Msc.	
6.	Suela Gërdhe	Prof.as.dr.	Menaxhim
7.	Aida Gabeta	Prof.as.dr.	
8.	Emil Frasheri	Dr.	
9.	Ledina Alolli	Prof.as.dr.	Marketing -Turizëm
10.	Landi Gushi	Msc.	
11.	Esmeralda Shkira	Prof.as.dr.	

III – PERSONELI I INSTITUCIONIT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit administron bazën e të dhënave mbi personelin akademik, ndihmës mësimesor shkencor dhe administrativ, bazuar në nenin 4, pika c dhe neni 5, pika 3 e rregullores së kësaj drejtorie.

<p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Midis të tjerash kjo bazë të dhënash përfshin dhe dokumentacion mbi organikën e FE si dhe jetëshkrimet e stafit akademik që mbulon programin e studimit dhe atij ndihmësimor dhe administrativ si dhe listën e personelit të punësuar pranë UNIKO.</p> <p>Vlerësimi i performancës të pedagogëve gjatë vitit akademik bëhet nga drejtuesit e njësisë duke përfshirë edhe vlerësimin nga studentët nëpërmjet pyetëso-rëve. Departamentet zhvillojnë periodikisht vlerësime të stafit akademik dhe mbajnë një bazë të dhënash për raportet e rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë etj</p> <p>Departamenti realizon periodikisht analizën mësimore dhe kërkimore pjesë e së cilës është dhe vlerësimi i personelit. Gjithashtu Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bazuar në Nenin 103, pika 3 të ligjit nr.80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit.</p> <p>Mbështetur në të dhënat e tabelës “ Tabela 5 Cilësia e stafit akademik”, Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 90% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për Programet e studimit të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit administron bazën e të dhënave mbi personelin akademik, ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ, bazuar në nenin 4, pika c dhe neni 5, pika 3 e rregullores së kësaj drejtorie.</p> <p>Midis të tjerash kjo bazë të dhënash përfshin dhe dokumentacion mbi organikën e FE si dhe jetëshkrimet e stafit akademik që mbulon programin e studimit dhe atij ndihmësimor dhe administrativ si dhe listën e personelit të punësuar pranë UNIKO.</p> <p>Vlerësimi i performancës të pedagogëve gjatë vitit akademik bëhet nga drejtuesit e njësisë duke përfshirë edhe vlerësimin nga studentët nëpërmjet pyetëso-rëve. Departamentet zhvillojnë periodikisht vlerësime të stafit akademik dhe mbajnë një bazë të dhënash për raportet e rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë etj</p> <p>Departamenti realizon periodikisht analizën mësimore dhe kërkimore pjesë e së cilës është dhe vlerësimi i personelit. Gjithashtu Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bazuar në Nenin 103, pika 3 të ligjit nr.80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit.</p> <p>Mbështetur në rregulloret e çdo programi studimi, konstatohet se të gjitha departamentet kanë angazhuar si titullare të lëndëve/moduleve për Programet e studimit të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku titullin Prof. /Prof.as.dr</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të</p>	<p>Në strukturën organizative janë përfshirë staf ndihmës mësimor dhe IT lidhur me angazhimin maksimal në funksion të ecurisë së</p>

<p>personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>punës dhe përmbushjes së objektivave (referuar „Tabela 3 Numri i stafit, 2018-2019Tabela 4 Shpërndarja e stafit administrativ“ Kjo është parashikuar si në organogramën e fakultetit, ashtu edhe në rregulloren e studimeve. Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimin.</p> <p>Për të siguruar zhvillimin praktikave profesionale dhe mësimore Fakulteti i Ekonomisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe privatë. Përveç praktikave në institucione, studentët e programit të studimit administrim biznesi në turizëm zhvillojnë dhe ekspedita mësimore. Departamenti Marketing-Turizëm angazhon pedagogë që ndjekin studentët në praktika. Këtë angazhim pedagogët e parashikojnë në formularin që bëjnë për ngarkesën vjetore të punës së tyre. Dërgimi i studentëve në praktika bëhet sipas një procedure standarde midis Departamentit-Dekanit dhe zyrës të prokurimeve në institucion.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Angazhimi në veprimtaritë kërkimore-shkencore dhe kualifikimi i vazhdueshëm janë pjesë e rëndësishme e punës së pedagogut. Rritja e cilësisë së mësimdhënies ka për bazë arritjet në punët kërkimore-shkencore të realizuara nga pedagogët e Fakultetit të Ekonomisë. Pedagogët e Fakultetit të Ekonomisë janë të angazhuar në kualifikimin e vazhdueshëm të tyre. Fakulteti mbështet zhvillimin e konferencave shkencore nga njësitë bazë dhe pjesëmarrjen e pedagogëve në konferenca dhe aktivitete të rëndësishme shkencore jashtë vendit të cilat pasqyrohen në faqen zyrtare të UNIKO.</p> <p>Duke njohur sfidat me të cilat ballafaqohet sot shoqëria jonë, UNIKO është përkushtuar për të siguruar arritje të qëndrueshme nëpërmjet programeve të kërkimit dhe zhvillimit, të cilat janë të hapura për të gjithë stafin.</p> <p>Në faqen zyrtare të UNIKO disponohet një bazë të dhënash për të gjithë të programet e studimeve të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë-i sipas cikleve</p>
<p>Konkluzione të GVB: Personeli akademik në Fakultetin e Ekonomisë përzgjidhet nëpërmjet kritereve të përcaktuara dhe miratuara nga njësitë përkatëse. Procedurat për përzgjedhjen dhe rekrutimin e stafit akademik janë</p>	

transparente. Nga ana tjetër stafi akademik vlerësohet mbi bazën e aftësive në mësimdhënie, kualifikimin kërkimor shkencor dhe respektimin e marrëveshjes të pedagogut dhe kontratës të punës

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Fakulteti i Ekonomisë disponon mjedise bashkëkohore dhe të mjaftueshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe orëve në laboratorët e informatikës dhe turizmit. Fakulteti i Ekonomisë ka një sipërfaqe prej 3170 m², si dhe një infrastrukturë moderne me kushte të përshtatshme për zhvillimin e mësimin dhe veprimtarive të tjera si: aktivitete shkencore, tryeza të rrumbullakta me biznesin, trajnime të studentëve, leksione të hapura me të ftuar, etj. Ai ka në përbërje: 7 salla leksionesh, 15 klasa për realizimin e orëve të seminareve, 2 laboratorë informatike, 1 laborator për turizmin, 1 sallë bibliotekë, 1 sallë internet, 1 zyrë për informimin e studentëve, etj. Infrastruktura e Fakultetit është e përshtatshme megjithatë është projektuar një investim në afat të shkurtër për përmirësimin e mëtejshëm të saj për ta bërë fakultetin e Ekonomisë një fakultet bashkëkohor.

Tregues të matshëm:

Mjediset e fakultetit dhe sipërfaqet totale jepen në Tabela 11 Mjediset e Fakultetit të Ekonomisë”

Tabela 11 Mjediset e Fakultetit të Ekonomisë

	Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin/et e studimit	Sasia	Sipërfaqja ne m2
	Salla për leksione	7	651
	Klasa për seminare	15	675
	Salla për aktivitete promovuese		
	Salla për praktikë lëndore/ profesionale		
	Laboratorë për lëndët	2	90
	Laboratorë informatike	2	70
	Salla interneti	1	30
	Salla për bibliotekë	1	100
	Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	30
	Zyrë informacioni për studentët	1	20
	Korridore/holle	11	800
	Ambjente ndihmëse	3	215
	Nyje hidrosanitare për studentët	3	75
	Zyra për stafin akademik	10	300
	Sipërfaqja totale e brendëshme		3056
	Ambjente m2/për student/Fakultet		
	Ambjente m2/për personel/Fakultet		

	Oborre/ambjente të jashtme/parkime/ambiente për aktivitete shlodhese	15 198.2m ²	E përbashkët për të gjithë universitetin
--	--	------------------------	--

Tabela 12 Mjediset për stafin

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	1	
Zyra për sekretarinë mësimore	1	
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore		
Zyra për personelin akademik	16	300
Zyrë për financën		
Zyrë për Njësinë e SBC		
Salla për mbledhje	1	
Mjedis për stafin e shërbimit	1	
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	1	
Norma m²/për person		

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programeve të studimit;</p>	<p>Në mjediset e fakultetit të ekonomisë funksionon Biblioteka Shkencore, dhe gjithashtu në godinën kryesore të universitetit ndodhet biblioteka kryesore e universitetit. Biblioteka qëndron e hapur nga ora 08:00 në 16:00, dhe funksionon përmes kartelave të regjistrimit. Biblioteka e fakultetit ka një fond prej rreth 5447 libra (në shqip dhe gjithë të huaj) për fusha të ndryshme të studimit që lidhen me programet e studimit të fakultetit ekonomik, dhe me një sipërfaqe rreth 100 m². Fondi i librave dhe revistave është i klasifikuar sipas natyrës së departamenteve dhe fushave përkatëse të studimit. Librat që ofron kjo bibliotekë janë të ndryshëm në përputhje me kërkesat e programeve të studimit. Ka përgjithësisht libra për ekonomisin, financë-kontabilitet, mikro dhe makro ekonominë, menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e projekteve, marketingun, turizmin, statistikën, etj.</p>

<p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programeve hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka drejtohet nga një punonjës i kualifikuar e trajnuar për të përmbushur të gjitha proceset e punës në bibliotekë. Biblioteka, e cila shërben njëkohësisht si sallë studimi me fonde të hapura , është e pajisur me kompjutera, internet si dhe me sistem ngrohje që u vjen në ndihmë studentëve për lexim dhe studim.</p> <p>Në dispozicion të stafit akademik dhe të studentëve është vënë dhe libraria elektronike (U-LIBRARY), që mundëson aksesimin online të një numri të konsiderueshëm revistash shkencore të shkencave ekonomike dhe të ngjashme. Kjo librari mund të aksesohet nga studentët dhe pedagogët nga kompjuterat ose telefonat smart. Në funksion të realizimit të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma të ndryshme të mësimdhënies për realizimin e mësimit. Këto platforma përdoren si për transmetimin e materialeve (leksione) tek studentët, por dhe si mënyra për vlerësimin e tyre, qoftë në formën e detyrave të kursit apo dhe në format të tjera që mund të përdoren për vlerësimin e studentëve.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programeve tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programeve;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së</p>	<p>Infrastruktura e Fakultetit të Ekonomisë përbëhet nga:</p> <p>7 salla leksionesh 50-100 vendesh, të gjitha të pajisura me projektor.</p> <p>15 salla për zhvillimin e seminareve</p> <p>2 laboratorë mësimorë dhe 2 laboratorë infromatike.</p> <p>1 bibliotekë e cila shërben njëkohësisht si sallë studimi është e pajisur me kompjutera, internet si dhe me sistem ngrohje që u vjen shumë në ndihmë studentëve për lexim.</p> <p>1 Zyrë informacioni për studentë.</p> <p>10 zyra për stafin akademik të pajisura me kompjutera për stafin, fortokopje dhe bibklioteka personale.</p> <p>Sekretaria Mësimore: Është njësia pranë së cilës zhvillohet procesi administrativ brenda Fakultetit, e cila është e pajisur me paisjet e duhura për zhvillimin normal të punës administrative, dhe konkretisht 3 sete Kompjuterash, 1 printer dhe 1 printer – fotokopje. Pranë sekretarisë mbahet edhe një pjesë e Arkivit, si edhe regjistrat bazë të shkollës.</p> <p>Zyra e Dekanit: -1- në të cilën Dekani kryen të gjithë veprimtarinë e tij administrative, të pajisura me 1 set</p>

<p>informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Kompjuter, 2 printera, rafta arkivimi, bibliotekë personale, TV.etj. Në paradhomën e zyrës së dekanit punon asistentja e tij, e cila shfrytëzon 1 set Kompjuter, 1 printer, 1 fotokopje, rafta arkivimi</p> <p>Mjediset e fakultetit të Ekonomisë janë të mbuluara me sinjal ËiFi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë web-in.</p>
<p><u>Konkluzione të GVB:</u></p> <p>Mbështetur në informacionin e siguruar infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godina është e rikonstruktuar dhe mobiluar, me sistem ngrohjeje qëndore në dimër dhe një pjesë e mjediseve (zyrave) edhe me sistem ftohjeje si dhe sistem internet me kabëll dhe ëireless. Mjediset e leksioneve dhe seminareve kanë siguruar një hapësirë të madhe për studentët. Në mjediset e leksioneve studion një numër rreth 100 studentë (klasat e godinës të masterit), ndërsa për një sallë seminaresh është përcaktuar një numër maksimal prej 40 studentësh. Duke parë kapacitetet e Fakultetit të Ekonomisë studentit i krijohet një mjedis komod dhe i mjaftueshëm për ndjekjen e procesit të mësimor.</p> <p>Studentët gëzojnë akses të plotë me internetin, cilësia e të cilit është e lartë. Çdo sallë leksioni është e pajisur me projektor. Laboratorët e informatikës dhe turizmit janë të pajisur me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Gjithashtu edhe biblioteka funksionon dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqip dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore, kërkimore dhe shkencore. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në departamente. Dekani dhe përgjigjësit e departamenteve janë akomoduar në zyra individuale.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, UNIKO funksionon sipas parimit të autonomisë financiare. UNIKO harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit. 3. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga UNIKO përdoren prej tij dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës. Përdorimi i fondeve publike nga UNIKO bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar. UNIKO financohet nga:

- Buxheti i Shtetit
- Pagesat e studentëve për arsimim
- Të ardhurat për shërbimet e kryera
- Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta

- Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi
- Veprimtari kërkimore-shkencore.⁴¹

Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik, ndahet ndërmjet personelit akademik dhe UNIKO, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Administrimit.⁴²

Mënyra e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e përcaktuara në këtë nen, me përjashtim të të ardhurave nga buxheti i shtetit, përcaktohet në Rregulloren financiare të UNIKO, që miratohet nga Bordi i Administrimit.

Administrimi i çështjeve financiare kryhet nga strukturat përkatëse të UNIKO, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të universitetit. Kompetencat dhe procedurat administrative në përgjithësi dhe të çdo njësie ndihmëse për çështje ekonomiko-financiare dhe administrative në veçanti, parashikohen në rregulloret përkatëse. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UNIKO dhe në njësitë e tij përbërëse realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm të UNIKO-së. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të kësaj njësie përcaktohet në rregulloren përkatëse të saj të miratuar nga Bordi i Administrimit. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UNIKO dhe në njësitë e tij përbërëse realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm të UNIKO-së. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të kësaj njësie përcaktohet në rregulloren përkatëse të saj të miratuar nga Bordi i Administrimit.

Tabela 13 Shpenzimet UNIKO për vitin 2018

Nr. Llog.	Zërat	Plan 2018	Fakt 2018
600	Paga	240,000,000	239,707,368
601	Sigurime Shoqërore	40,000,000	39,989,008
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,000,000	4,925,377
606	Transferta per Buxh.fam dhe Indiv.	25,227,000	21,833,925
600	Paga	58,318,462	36,737,624
601	Sigurime Shoqërore		
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	68,107,370	46,455,475
606	Transferta per Buxh.fam dhe Indiv.	400,000	356,903
A	Total shpenzime kapitale	437,052,832	390,005,680
230	Kapitale të Patrupëzuara	272,000	172,000
231	Kapitale të Trupëzuara	55,592,090	45,628,294
B	Total shpenzime korrente	55,864,090	45,800,294
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	182,689,922	129,350,296
C	TOTAL (A) + (B)	492,916,922	435,805,974

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Referur Ligjit 80/2015 për arsimin e lartë, ligjit organik të buxhetit dhe ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, për zbatimin e buxhetit është ndjekur një politikë transparente e shpërndarjes së burimeve financiare nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Organizimit të takimeve periodike të përmuajshme me organet drejtuese të universitetit (Rektorat, Senat Akademik, Bord Administrimi), me qëllim njohjen me ecurinë e zbatimit të buxhetit dhe transparencën në veçanti të zërave analitikë buxhetorë. <input type="checkbox"/> Organizimit të takimeve të hapura të analizave vjetore të punës me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve. <p>Zbatimi i buxhetit është realizuar duke u kujdesur për respektimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, duke mundur në këtë mënyrë edhe raportime të evidencave financiare pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave konform sistemit informatik të programit buxhetor.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin</p>	<p>UNIKO ka në strukturën e tij Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë e Financës. Drejtoria e Financës ka në përbërje Sektorin e Menaxhimit të Buxhetit dhe të të Ardhurave dhe Sektorin e Shërbimeve Financiare. Drejtoria Ekonomike ka në përbërje Sektorin e Prokurimeve dhe Investimeve dhe Sektorin e Shërbimeve. Ndarja e të ardhurave është me kategori sipas burimeve financiare. Shpenzimet kategorizohen sipas llogarive përkatëse. Raportet financiare mbahen në zyrën e financës. Bilancet vjetore pasqyrojnë një gjendjen financiare, kapacitetet për situatën financiare, numrit të studentëve për gjenerimin e të ardhurave. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UK dhe në njësitë e tij përbërëse realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm të UK-së. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të kësaj njësie përcaktohet në rregulloren përkatëse të saj të miratuar nga Bordi i Administrimit.</p> <p>Analiza e treguesve të monitorimit financiar konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizimin e efektivitetit të shpenzimeve, krahasuar me periudhat e mëparshme. - Analizimin e shkaqeve, në rastet e mosrealizimit të planit të investimeve

<p>e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndikimi që kanë pasur zëra të ndryshëm të shpenzimeve buxhetore (referuar numrit të përfituesve direktë dhe jodirektë). - Raportimet mbi performancën gjatë zbatimit (muaj pas muaji) të buxhetit, specifikohen në mënyrë të detajuar dhe raportohen në takimet e zhvilluara me organet kolegjiale të universitetit (kryesisht me Bordin e Administrimit). - Këto raportime janë fokusuar kryesisht në informacionin mbi arritjet (në terma sasiore dhe vlera të zërave buxhetorë), duke identifikuar mosarritjet, shkaqet e tyre, si dhe duke propozuar në të njëjtën kohë, masa për përmirësimin e situatës
--	---

Konkluzione të GVB:

Universiteti realizon menxhimin financiar, harton planin buxhetor dhe monitoron zbatimin e tij sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Ai ka në pronësi, mirëmban dhe përmirëson cilësinë e pasurive të paluajtshme dhe asetëve, të cilat janë në dispozicion të veprimtarisë akademike dhe shkencore. Organizimin dhe mbajtje të rregullt të të dhënave financiare të institucionit. Dokumentacioni i lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet është i rregullt dhe dëshmohet edhe nga rezultatet e kontrolleve periodike të cilave u është nënshtruar institucioni.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programeve të studimit

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit çdo vit vlerësime të cilësisë, të cilat janë diskutuar dhe në mbledhje të veçanta në senat. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm është një organizëm që ngrihet dhe funksionon në nivel institucioni i cili ka përgjegjësinë për të garantuar se Fakulteti i Ekonomisë plotëson standardet e cilësisë. Ky organizëm përgjigjet për politikën së vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. GVB i raporton drejtpërdrejtë NJSBC në institucion. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në mënyrë më specifike kujdesen strukturat organizative drejtuese të UNIKO, të cilat janë ngritur e veprojnë konform kërkesave të Ligjit 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Aktivitetin e saj NJSBC e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar të përvitshëm, në të cilin programohen kontrollet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit, e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.

Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Msc.Aida Mosko	koordinatore	3 vite
2	Prof.as.dr. Oriola Theodhori	anëtar	10 vite

3	Doc.dr. Marinela Teneqexhi	anëtar	10 vite
4	Edisnajda Shaholli	student	2 vite

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin Programet e studimit, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; 	<p>Fakulteti i Ekonomisë përdor metodologji vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit, të cilat diskutohen në mbledhjet e departamenteve me qëllim që të ndërmeren hapat e nevojshëm në këtë drejtim. Këto rezultate i vihen në dispozicion NJBSC në shkallë universiteti.</p> <p>Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimin e cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBC.</p> <p>Institucioni merr feedback lidhur me cilësinë e programeve që ofron, edhe nga kontakti me ish- studentët e tij, Alumni.</p> <p>Një informacion e vlefshëm sigurohet edhe nga studentët të cilët ndjekin trajnime pranë Qendrës së Formimit të Vazhduar trajnime sipas akteve ligjore në fuqi.</p> <p>Për çdo vit akademik Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë harton kalendarin e veprimtarisë së sektorit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë i cili ndiqet nga NJSBC së fakultetit.</p> <p>NJSBC kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me pyetësorë me të gjithë studentët, për lëndët dhe pedagogët. Rezultatet përpunohen në raporte periodike</p>

<p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatat);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin Programet e studimit që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, Universiteti “Fan S. Noli Korçë (UK) është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Organet kolegjiale, janë ato të cilat përmes shqyrtimit dhe miratimit hartojnë të gjitha politikat, strukturat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë. UK harton standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe MASR. Parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë specifikohen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Institucioni ka të zyrtauar Planin Strategjik 2016-2020 dhe në të janë të parashtruara politikat dhe procedurat që do të ndjekë institucioni në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Vlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave të rëndësishme sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë Universitetit në lidhje me programet e studimit, përmirësimin e mësimdhënies së studentëve dhe vlerësimin nëse po përmbushen standardet akademike. Ky proces përbëhet nga një procedurë zhvillimi aktivitetesh të rregullta monitoruese dhe përmirësimi. Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës mësimor, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet.</p> <p>FE ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe</p>

	<p>vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore- shkencore.</p> <p>Grupet e punës që hartojnë raportin e vetvlerësimit bashkëpunojnë me struktura të ndryshme si: Dekani I FE; Përgjegjës njësie bazë; sekretari mësimore; Zyra e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional; Dega e Financës; Dega e Studimeve dhe Karrierës Studentore; Sektori I Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë.</p>
<p><u>Konkluzione të GVB:</u></p> <p>FE ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore- shkencore. Grupet e punës që hartojnë raportin e vetvlerësimit bashkëpunojnë me struktura të ndryshme</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programet e studimit, organizimi i tyre.

Qëllimi themelor i Fakultetit të Ekonomisë është transmetimi tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik ose praktik, duke mbajtur parasysh formimin e kompetencave të studentëve. Pra, synohet përgatitja e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe të marrin vendime të sakta, si dhe të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve dhe programeve të studimit ku ata specializohen.

Ky objektivi realizohet:

- (1) duke përpunuar e zgjedhur programe disiplinash sa më cilësore për çdo lëndë e që zhvillohet në Fakultetin e Ekonomisë;
- (2) duke përdorur si literaturë bazë dhe plotësuese libra, autorë dhe shtëpi botuese nga më të spikaturat e fushës, të njohura në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- (3) nëpërmjet zhvillimit të leksioneve dhe seminareve me metoda bashkëkohore dhe interaktive, duke përdorur gjerësisht prezantimet problemore, analizën logjike e sasiore, analizat krahasuese e kontekstuale, pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione e seminare, debatin e improvizuar, etj. Kurset e studimit zhvillohen në bazë të planit mësimor të miratuar në Senatin e Universitetit. Për të siguruar një formim sa më bashkëkohor të studentëve planet mësimore janë rinovuar nga viti në vit, duke ruajtur një raport të pranueshëm midis grup lëndëve të formimit të përgjithshëm, formimit bazë, formimit special dhe lëndëve me *zgjedhje*.

Elementët që përbëjnë strukturën e programeve të studimit në UK, janë përcaktuar në aktet nënligjore dhe konstistojnë në:

- a. Kreditet sipas ECTS;
- b. Kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
- c. Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale;
- d. Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
- e. Kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi;
- f. Planin mësimor;
- g. Kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;
- h. Programin lëndor (syllabuset);
- i. Profilin e programit;
- j. Diplomën dhe suplementin

Tabela 14 Programet e studimit dhe lëndët sipas tipit të veprimtarisë

Nr	BA/ MP/MSc/ PP	EMËRTIMI I PROGRAMIT	NR I LËNDËVE SIPAS TIPIT TË VEPRIMTARISË						TOTALI
			A	B	C	D	E	F	
1.	Bachelor	Financë-Kontabilitet	6	18	6	6	1		37
2.	Bachelor	Ekonomiks	6	16	5	5	1		33
3.	Bachelor	Menaxhim	6	19	5	5	1		36
4.	Bachelor	Informatikë Biznesi	6	19	5	4	1		35
5.	Bachelor	Administrim Biznesi në Marketing	6	19	3	2	5		35
6.	Bachelor	Administrim Biznesi në Turizëm	6	19	3	2	5		35
7.	Bachelor	Biznes dhe Tregti	5	21	4	5	1		36
8.	Master Profesional _(60 kredite)	Financë-Kontabilitet	1	5	4	2	1		13
9.	Master Profesional _(90 kredite)	Financë-Kontabilitet	2	6	2	3/1	3	1	14
10.	Master profesional	Bankë dhe Sigurime	1	5	4	2	1		13
11.	Master Profesional _(60 kredite)	Administrim Biznesi	1	5	4	1	1		12
12.	Master Profesional _(90 kredite)	Administrim Biznesi	2	6	2	1	2	1	14
13.	Master Profesional	Marketing	2	6	2	1	2		13
14.	Master Profesional	Turizëm	2	6	2	1	2		13
15.	Master i Shkencave	Financë	1	11	4	2	1		19
16.	Program Profesional	Asistent Menaxher	3	12	3	3	1		22

Organizimi i programeve të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Struktura për sistemin 3-vjeçar të studimit (Bachelor) të fakultetit të Ekonomisë është si më poshtë:

Tabela 15 Struktura e programit të studimit BCH në Financë-Kontabilitet

BCH në Financë-Kontabilitet	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 simestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	180 ECTS
Orë mësimore në auditor	2054 orë
Orë mësimore jashtë auditorit	2446 orë
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 16 Struktura e programit të studimit BCH në Menaxhim

BCH në Menaxhim	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 simestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	180 ECTS
Orë mësimore në auditor	2066
Orë mësimore jashtë auditorit	2434
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 17 Struktura e programit të studimit BCH në Administrim Biznesi në Marketing

BCH në Administrim Biznesi në Marketing	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 simestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	180 ECTS
Orë mësimore në auditor	2107
Orë mësimore jashtë auditorit	2393
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 18 Struktura e programit të studimit BCH në Administrim Biznesi në Turizëm

BCH në Administrim Biznesi në Turizëm	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 simestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	180 ECTS
Orë mësimore në auditor	2107
Orë mësimore jashtë auditorit	2393
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 19 Struktura e programit të studimit BCH në Ekonomiks

BCH nw Ekonomiks	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 simestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	180 ECTS

Orë mësimore në auditor	1898
Orë mësimore jashtë auditorit	2602
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 20 Struktura e programit të studimit BCH në Informatikë Biznesi

BCH nw Informatikw Biznesi	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 semestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	180 ECTS
Orë mësimore në auditor	2018
Orë mësimore jashtë auditorit	2482
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 21 Struktura e programit të studimit BCH në Biznes dhe Tregëti

BCH në Biznes dhe Tregëti	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 semestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	180 ECTS
Orë mësimore në auditor	2110
Orë mësimore jashtë auditorit	2390
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Struktura për sistemin “Master Profesional ” (90ECTS) të Fakultetit të Ekonomisë është si më poshtë:

Tabela 22 Struktura e programit të studimit MP në Financë-Kontabilitet (90 ECTS)

MP në Financë-Kontabilitet (90 ECTS)	
Kohëzgjatja e studimeve	1,5 Vite akademike 3 semestra 45 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	90 ECTS
Orë mësimore në auditor	1125orë
Orë mësimore jashtë auditorit	1125 orë
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 23 Struktura e programit të studimit MP në Administrim Biznesi (90 ECTS)

MP në Menaxhim (90 ECTS)	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 semestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	90 ECTS
Orë mësimore në auditor	1100
Orë mësimore jashtë auditorit	1150

Ngarkesa minimale javore	25 orë
--------------------------	--------

Tabela 24 Struktura e programit të studimit MP në Marketing (90 ECTS)

MP në Administrim Biznesi në Marketing (90 ECTS)	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 simestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	90 ECTS
Orë mësimore në auditor	1100
Orë mësimore jashtë auditorit	1150
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 25 Struktura e programit të studimit MP në Turizëm (90 ECTS)

MP në Administrim Biznesi në Turizëm (90 ECTS)	
Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 simestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	90 ECTS
Orë mësimore në auditor	1085
Orë mësimore jashtë auditorit	1165
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Struktura për sistemin “Master Profesional ” (60ECTS) të Fakultetit të Ekonomisë është si më poshtë:

Tabela 26 Struktura e programit të studimit MP në Financë-Kontabilitet (60 ECTS)

MP në Financë-Kontabilitet (60 ECTS)	
Kohëzgjatja e studimeve	1 Vit akademik 2 semestra 30 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	60 ECTS
Orë mësimore në auditor	630
Orë mësimore jashtë auditorit	870
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 27 Struktura e programit të studimit MP në Administrim Biznesi (60 ECTS)

MP në Menaxhim (60 ECTS)	
Kohëzgjatja e studimeve	1 Vit akademik 2 semestra 30 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	60 ECTS
Orë mësimore në auditor	710
Orë mësimore jashtë auditorit	790
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 28 Struktura e programit të studimit MP në Marketing (60 ECTS)

MP në Administrim Biznesi në Marketing (60 ECTS)	
Kohëzgjatja e studimeve	1 Vit akademik 2 semestra 30 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	60 ECTS
Orë mësimore në auditor	700
Orë mësimore jashtë auditorit	800
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 29 Struktura e programit të studimit MP në Turizëm (60 ECTS)

MP në Administrim Biznesi në Turizëm (60 ECTS)	
Kohëzgjatja e studimeve	1 Vit akademik 2 semestra 30 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	60 ECTS
Orë mësimore në auditor	690
Orë mësimore jashtë auditorit	810
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Tabela 30 Struktura e programit të studimit MP në Bankë dhe Sigurime (60 ECTS)

Master Profesional në Bankë dhe Sigurime	
Kohëzgjatja e studimeve	1 Vit akademik 2 semestra 30 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	60 ECTS
Orë mësimore në auditor	603
Orë mësimore jashtë auditorit	897
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Struktura për sistemin “Master i Shkencave ” të Fakultetit të Ekonomisë është si më poshtë:

Tabela 31 Struktura e programit të studimit MSH në Financë

Master shkencor në Financë	
Kohëzgjatja e studimeve	2 Vite akademike 4 semestra 60 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	120 ECTS
Orë mësimore në auditor	1495
Orë mësimore jashtë auditorit	1505
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Struktura për sistemin “Program Profesional 2-vjeçar ” të Fakultetit të Ekonomisë është si më poshtë:

Tabela 32 Struktura e programit profesional 2-vjeçar "Asistent Menaxher"

Program Profesional 2-vjeçar "Asistent Menaxher"	
Kohëzgjatja e studimeve	2 Vite akademike 4 semestra 60 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	ECTS
Orë mësimore në auditor	1325
Orë mësimore jashtë auditorit	1675
Ngarkesa minimale javore	25 orë

**Emërtimi i Diplomës për programin e studimit**

Përgjegjësit e departamenteve administrojnë programet e studimit dhe koordinojnë mësimdhënien, mësimnxënien dhe veprimtarinë kërkimore në shkallë departamenti, duke raportuar te dekani i fakultetit, i cili koordinon veprimtaritë e departamenteve.

Programet e studimit pasqyrojnë Misionin, Planin Strategjik dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit, duke synuar kryesisht përmbushjen e nevojave rajonale ekonomike dhe sociale.

Fakulteti ofron kualifikime përgjatë të dy cikleve me 7 programe Bachelor, 5 Master Profesional, 1 program Master i Shkencave dhe 1 program studimi profesional dyvjeçar pas arsimit të mesëm. Në faqen e internetit të institucionit, publikohen informacione rreth programeve të studimit, duke përfshirë informacione për strukturën e kursit, për mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe për kreditet ECTS¹⁷.

Rregulloret përkufizuese të secilit program studimi përfshijnë informacion të përgjithshëm rreth kurrikulës, mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësimit, pranimeve, infrastrukturës dhe mbështetjes, si dhe mundësive për punësim. Rregulloret dhe informacioni për çdo njësi hidhen në faqen e internetit dhe janë të disponueshme në sistemin digjital ESSE3 të universitetit¹⁸.

Fakulteti i Ekonomisë jep diploma me emërtimet si në Tabela 33.

Tabela 33 Diplomat sipas cikleve dhe programeve të studimit

Nr.	Programet e studimit	Emërtimi i diplomës
A.	Bachelor	
1.	Financë-Kontabilitet	Diplome universitare, "Bachelor" në Financë-Kontabilitet

¹⁷ . <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

¹⁸ Rregullore ESSE3

<http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/rregullore%20per%20esse3%20update%2019%204%202017.pdf>

2	Financë-Kontabilitet	Diplome universitare, "Bachelor" në Ekonomiks
3.	Menaxhim	Diplome universitare, "Bachelor", në Menaxhim
4	Menaxhim	Diplome universitare, "Bachelor", në Informatikw Biznesi
5.	Administrim Biznesi në Marketing	Diplome universitare, "Bachelor", në Administrim biznesi në Marketing
6	Administrim Biznesi në Turizëm	Diplome universitare, "Bachelor", në Administrim biznesi në Turizëm
7	Administrim Biznesi në Turizëm	Diplome universitare, "Bachelor", në Biznes dhe tregwti
B.	Master Profesional	
1	Master Profesional në Financë-Kontabilitet	Diplomë në "Master Profesional" në Financë-Kontabilitet
2	Master Profesional në Financë-Kontabilitet	Diplomë në "Master Profesional" në Bankw dhe sigurime
3	Master Profesional në Administrim Biznesi	Diplomë në "Master Profesional" në Administrim Biznesi
4	Master Profesional në Marketing	Diplomë në "Master Profesional" në Marketing
5	Master Profesional në Turizëm	Diplomë në "Master Profesional" në Në Turizëm
C.	Master Shkencor	
1	Master Shkencor në Financë	Diplomë Master i shkencave në Financë
D.	Program profesional 2-vjeçar	
1.	Program profesional 2-vjeçar "Asistent Menaxher"	

Plani mësimor

Planet mësimore për çdo program studimi jepen të detajuara në faqen zyrtare të UNIKO dhe fakultetit përkatës. Ato parashikojnë:

Kodin e disiplinës

Emërtimin e lëndës /modulit

Kodin

Vitin akademik

Orët gjithsej (të ndara në leksione dhe seminare)

Orët për studim individual të studentit

Deyra, projekte, laboratore apo praktika

Detyrimin për lëndën

Ndarjen sipas semestrit

Numrin e krediteve të cilat hidhen në formatin e Tabela 34 më poshtë.;

Tabela 34 Shembull i formatit të tabelës për detajimin e planit mësimor të programit të studimit

Viti I (Viti II) (Viti III)	Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	Provime
					Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë						
					ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
1	Lënda 1																			
2	Lënda 2																			
3	...																			
	Totali		60																	



Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit, ndarja e orëve në auditor dhe jashtë auditorit për leksione, seminare, laboratore, praktika apo provime, detajohet nga secili pedagog në sylabusin e lëndës:



Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F)

Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- i)** Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
- ii)** Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
- iii)** Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;
- iv)** Lëndë plotësuese, të fokusuar në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;
- v)** Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar. sipas shembullit të mëposhtëm:

Tabela 35 Struktura e planit mësimor: Programi Biznes dhe Tregëti

Tipi i veprimtarisë dhe Kategoria përcaktuese	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera formuese	Kredite	Totali i krediteve
LËNDË BAZË-Përgatitje metodologjike dhe kulturë përgjithshme (Simboli: A)	1. Hyrje në Ekonomi	6	34
	2. Mikroekonomi dhe makroekonomi	6	
	3. Matematika e biznesit	6	
	4. Statistikë 1	6	
	5. Ekonomiksi i transportit	5	
	6. Statistika 2	5	
LËNDË KARAKTERIZUESE- Përgatitje për disipinen shkencore (Simboli: B)	1. Bazat e marketingut	6	95
	2. Menaxhim biznesi	6	
	3. Bazat e financës	5	
	4. Kontabilitet financiar	5	
	5. Kërkimi marketing	5	
	6. Marketingu i shërbimeve	5	
	7. Marketingu ndërkombëtar	5	
	8. Drejtimi financiar	5	
	9. Sipërmarrja dhe menaxhimi i biznesit të	4	
	10. Drejtimi marketing	5	
	11. Sjellja konsumatore	5	
	12. Drejtimi i kanaleve marketing	5	
	13. Menaxhimi i burimeve njerëzore	5	
	14. Menaxhimi i forcës shitëse dhe shitja personale	5	
	15. Strategjia marketing dhe pozicionimi në treg	5	
	16. Komunikimi i integruar në marketing	5	
	17. Marketingu direkt	5	

	18.Menaxhimi i operacioneve	4	
--	-----------------------------	---	--

Për secilin program studimi, në rregullore plotësohet edhe Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës si shembulli në Tabela 36 Plani mësimor i programit "Biznes dhe Tregëti" Tabela 36.

Tabela 36 Plani mësimor i programit "Biznes dhe Tregëti"

Nr.	Lëndët	SEMESTRI						Tipi i Veprimtarisë	Orë në auditor	Orë jashtë auditorit	Orë gjithsej	Frekuenti mi	ECTS	Pedagogët
		VITI I		VITI II		VITI III								
		I	II	I	II	I	II							
1.	Hyrje në Ekonomi	X						A	75	75	150	D	6	Prof. as. dr. Majlinda Dine
2.	Bazat e marketingut	X						B	60	90	150	D	6	Prof. as. dr. Mamica Nene Msc. Erjon Nexhipi
3.	Matematika e biznesit	X						A	75	75	150	D	6	Dr. Ilir Palla
4.	Gjuhë e huaj 1	X						D	45	55	100	D	4	Dr. Dorela Konomi
5.	Komunikimi në biznes	X						C	60	90	150	D	6	Prof. as. dr. Suela Gërdhe
6.	Bazat në industrinë e mikpritjes	X						C	60	65	125	D	5	Prof.as. dr. Esmeralda Shkira
7.	Mikroekonomi dhe makroekonomi		X					A	60	90	150	D	6	Prof.as. dr. Eleni Vangjeli
8.	Statistika 1		X					A	60	90	150	D	6	Dr. Ilir Palla
9.	Menaxhim biznesi		X					B	60	90	150	D	6	Prof.as. dr. Sonela Stillo
10.	Gjuhë e huaj 2		X					D	45	55	100	D	4	Dr. Dorela Konomi
11.	Sociologji		X					C	60	65	125	Z	5	Dr. Mariglana Hoxhaj Msc. Iva Pendavinji
	E drejtë biznesi		X				C	Z				5		
	GJITHSEJ VITI I								660	865	1500		60	
12.	Statistikë 2			X				A	60	65	125	D	5	Dr. Marinela Teneqexhi
13.	Biznesi, shoqëria dhe politikat			X				B	60	65	125	D	5	Dr. Alma Zhilla
14.	Ekonomiksi i transportit			X				B	60	65	125	D	5	Dr. Denada Olli
15.	Bazat e financës			X				B	60	65	125	D	5	Dr. Kostandin Nasto
16.	Kontabilitet financiar			X				B	60	65	125	D	5	Prof.as. dr. Frederik Çuçllari
17.	Informatikë			X				D	60	65	125	D	5	Dr. Rafail Prodani
18.	Gjuhë e huaj 3			X				D	30	20	50	D	2	Dr. Dorela Konomi

19.	Kërkimi marketing				X			B	60	65	125	D	5	Dr. Landi Gushi
20.	Drejtimi i kanaleve marketing				X			B	60	65	125	D	5	Prof.as. dr. Mamica Nene
21.	Menaxhimi i forcës shitëse dhe shitja personale				X			B	60	65	125	D	5	Msc. Erjon Nexhipi
22.	Sipërmarrja dhe menaxhimi i biznesit të vogël				X			B	60	40	100	D	4	Prof. as. dr. Aida Gabeta
23.	Drejtimi financiar				X			B	60	65	125	D	5	Dr. Sorina Koti
24.	Menaxhimi i operacioneve				X			B	60	40	100	D	4	Prof. as. dr. Mirela Cini
	GJITHSEJ VITI II								750	750	1500		60	
25.	Drejtimi marketing					X		B	75	50	125	D	5	Prof. as. dr. Oriola Theodhori
26.	Sjellja konsumatore					X		B	75	50	125	D	5	Prof. as. dr. Ledina Alolli
27.	Marketingu i shërbimeve					X		B	60	65	125	D	5	Prof. as. dr. Mamica Nene
28.	Menaxhimi i burimeve njerëzore					X		B	60	65	125	D	5	Prof. as. dr. Sonela Stillo
29.	Komunikimi i integruar në marketing					X		B	60	65	125	D	5	Prof. as. dr. Eleina Qirici
30.	Menaxhimi i marrëdhënieve me konsumatorët					X		B	60	65	125	D	5	Prof. as. dr. Esmeralda Shkira
31.	Strategjia marketing dhe pozicionimi në treg						X	B	65	60	125	D	5	Prof. as. dr. Ledina Alolli
32.	Marketingu direkt dhe Online						X	B	65	60	125	D	5	Prof. as. dr. Oriola Theodhori
33.	Marketingu ndërkombëtar						X	B	65	60	125	D	5	Dr. Maringlena Hoxhaj
34.	Menaxhimi i ngjarjeve						X	C	65	85	150	Z	6	Dr. Denada Olli
	Marketingu ndërkulturor							C				Z		Dr. Landi Gushi
	Rregullat e reja të marketingut dhe marrëdhënieve publike							C				Z		Dr. Maringlena Hoxhaj
35.	Praktika						X	D	25	25	50	D	2	
36.	Mikrotezë						X	E	50	125	175	D	7	
	GJITHSEJ VITI III								700	800	1500		60	
	SHUMA E KREDITEVE DHE ORËVE								2110	2390	4500		180	

Syllabus-et për çdo lëndë

Për secilën lëndë/ modul hartohen sylabueset e saj me elemente standarde të përcaktuara me VKM.

Syllabuset përmbajnë këto elemente:

I- Titullari /pedagogu i lëndës: (emri, titulli akademik, grada shkencore dhe nënshkrimi)
 Ngarkesa: (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.)

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/semestri kur zhvillohet:

Lloji i lëndës: (e detyrueshme ose me zgjedhje)

Programi i studimit: (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë)

Kodi i lëndës:

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

II- PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT: (Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundimi të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritët të përvetësojë në përfundim të lëndës)

III- KONCEPTET THEMELORE: (janë koncepte e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda) 1.

2.

3. ...

IV- TEMAT E LËNDËS shpjegimi (rreth një paragrafi) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe)

Tema I –

Tema II –

Tema III –

V- FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE FREKUENTIMI: KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

(renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar etj.) **VI- LITERATURA** (literatura paraqet listën e botimeve që studenti duhet të lexojë gjatë lëndës, e ndarë në) a) Literatura bazë e detyrueshme: b) Literatura e rekomanduar: **VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS** (hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka)

PROGRAMI I LËNDËS: Ekonomi

Moduli I. Hyrje në Ekonomi

Titullari /pedagogu i lëndës: Prof.as. dr. Majlinda Bello (Dine)

Ngarkesa: 6 kredite, 45 orë leksion, 30 orë seminar, 75 orë punë e pavarur, 20 orë kolokium, 35 orë provimi final, 20 orë projekti semestral.

Tipologjia e lëndës: A

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti I/ Semestri I, 2019-2020

Lloji i lëndës: E detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Biznes dhe Tregti”

Kodi i lëndës: BT-A-01A

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: majlinda_bello@yahoo.com

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Vendimet ekonomike kanë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e jetës së njerëzve në të gjithë botën. Studimi i ekonomisë mund të ndihmojë individët, grupet dhe shoqëritë të bëjnë zgjedhje që i ndihmojnë ata për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Disiplina e ekonomisë ka një bazë teorike dhe ekonomistët shpesh debatojnë meritat relative të teorive të ndryshme kur vlerësohen çështjet ekonomike dhe propozojnë zgjidhje për problemet ekonomike, duke përfshirë modelimin ekonomik.

Diskutimi i çështjeve ekonomike dominon mediat dhe politikën. Duke kuptuar ekonomi, studentët mund të bëjnë gjykime të informuara për çështje dhe politika të përgjegjshme dhe të marrin pjesë në vendimmarrje. Lënda u mundëson nxënësve që të zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit, shkathtësinë, qëndrimet dhe vlerat duke përdorur metodologji që i përshtaten interesave të tyre. Studentët përfitojnë nga këto njohuri edhe kur ata ndjekin arsimin e mëtejshëm dhe trajnimin, punësimin dhe pjesëmarrjen aktive si qytetarë.

Qëllimi i Ekonomisë është që të zhvillojë njohuritë, të kuptuarit, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e studentëve për të menduarit efektiv të çështjeve ekonomike që kontribuon për rritjen e përgjegjësisë shoqërore dhe vendimmarrjes kompetente në një ekonomi në ndryshim.

Nëpërmjet studimit të Ekonomisë, studentët do të zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit në lidhje me: • sjelljen ekonomike të individëve, firmave, institucioneve dhe qeverive • funksionin dhe funksionimin e tregjeve • funksionimin dhe menaxhimin e ekonomive • problemet bashkëkohore ekonomike dhe çështjet me të cilat ballafaqohen individët, firmat dhe qeveritë; rritin aftësitë që të: • të hetojnë dhe të angazhohen në analiza efektive, dhe vlerësimin e informacionit ekonomik nga një shumëllojshmëri e burimeve; • të nxitë pjesëmarrjen e informuar në debatin ekonomik dhe vendim-marrje si dhe • qasje të përgjegjshme ndaj njerëzve, shoqërive dhe mjediseve.

KONCEPTET THEMELORE:

Kërkesa, oferta, elasticiteti, konkurrenca e plotë, monopoli, oligopoli, produkti i përgjithshëm, inflacioni, papunësia, rritja ekonomike, paraja dhe sistemi bankar, politika monetare, politika fiskale.

Java I. Një vështrim i përgjithshëm mbi shkencën ekonomike (Hyrje në Ekonomi, fq. 1-22)

Ç'është Ekonomiksi?

Kufiri i mundësive të prodhimit dhe kostoja oportune

Pamje e përgjithshme e ekonomisë së tregut

Përse është e nevojshme njohja e Ekonomiksit

Metodologjia e shkencës ekonomike

Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.8-18)

Java II. Kërkesa, oferta, ekuilibri i tregut (Hyrje në Ekonomi, fq. 24-46)

Kërkesa dhe kurba e kërkesës

Oferta dhe kurba e ofertës

Ekuilibri i tregut

Disekuilibri

Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.20-31)

<p>Elasticiteti i kërkesës dhe ofertës (Hyrje në Ekonomi, fq. 48-62) Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin Faktorët që përcaktojnë elasticitetin e kërkesës lidhur me çmimin Lloje të tjera të elasticitetit Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.33-43)</p>
<p>Java III. Sjellja konsumatore (Hyrje në Ekonomi, fq. 64-83) Zgjedhja racionale dhe vendimet e konsumatorit Dobia marxhinale dhe kërkesa e konsumatorit Qëndrimi kardinalist Zgjedhja konsumatore dhe ligji i kërkesës Analiza ordinaliste e zgjedhjes konsumatore Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.46-56)</p>
<p>Java IV. Firmat (Hyrje në Ekonomi, fq. 85-98) Firma dhe objektivat e saj Llojet e firmave Rrugët e rritjes së kapitalit nga firmat Kontabiliteti i firmës. Bilanci dhe pasqyra e rezultatit financiar Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.58-61) Teoria e prodhimit dhe produktit marxhinal (Hyrje në Ekonomi, fq. 100-113) Funksioni i prodhimit në periudha afatshkurtra Ligji i të ardhurave zbritëse Të ardhurat e shkallës, faktori kohë dhe ndryshimet në teknologji Funksioni i prodhimit në periudha afatgjata Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.64-75)</p>
<p>Java V. Kostoja (Hyrje në Ekonomi, fq. 116-132) Kostot në periudha afatshkurtra Kostoja oportune Kostua në periudhat afatgjata Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.78-90)</p>
<p>Java VI. Përcaktimi i çmimeve në konkurrencë të plotë (Hyrje në Ekonomi, fq. 134-158) Tiparet e tregut konkurrencial dhe kurba e kërkeses së firmës Vendimet dhe oferta e firmës në një periudhë afatshkurtër Sjellja e firmës dhe e degës në periudha afatgjata Konkurrenca e plotë dhe efienca ekonomike Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.92-101)</p>
<p>Java VII. Monopoli (Hyrje në Ekonomi, fq. 160-177) Monopoli dhe tiparet e tij Kurba e kërkesës dhe maksimizimi i fitimit në firmën monopol Efienca në kushtet e monopolit dhe kritika e tij Diskriminimi i çmimeve në kushtet e monopolit Politikat shtetërore për kontrollin e monopolit Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.104-115) Forma të tjera të konkurrencës jo të plotë (Hyrje në Ekonomi, fq. 179-193) Tiparet e konkurrencës monopolistike Maksimizimi i fitimit për firmën në konkurrencë monopolistike</p>

<p>Oligopoli, llojet dhe baza e egzistences së tij</p> <hr/> <p>Modele të oligopolit</p> <p>Ushtrime (Hyrje në Ekonomi fq.118-129)</p>
<p>Java VIII. Shpërndarja e të ardhurave (Hyrje në Ekonomi, fq. 195-222)</p> <p>Bazat teorike të shpërndarjes së të ardhurave</p> <p>Paga si çmim i faktorit punë</p> <p>Renta si çmim i tokës</p> <p>Interesi si çmim i kapitalit</p> <p>Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.132-143)</p>
<p>Java IX. Sektori publik (Hyrje në Ekonomi, fq. 223-241)</p> <p>Përse është e nevojshme ndërhyrja e shtetit në ekonomi</p> <p>Sektori publik dhe përmasat e tij</p> <p>Financimi i sektorit publik</p> <p>Zgjedhja publike</p> <p>Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.146-155)</p>
<p>Java X. Pjesa e dytë : MAKROEKONOMI</p> <p>Hyrje në makroekonomi</p> <p><i>I. Një vështrim i shkurtër historik mbi makroekonominë</i> (Hyrje në Ekonomi, fq. 245-254)</p> <p>Makroekonomia si degë e Ekonomiksit.</p> <p>Konceptet kryesore makroekonomike</p> <p>Objektivat kryesore makroekonomike dhe mjetet politike të realizimit të tyre</p> <p>Instrumentat kryesore të analizës makroekonomike</p> <p><i>II. Matja e produktit të përgjithshëm</i> (Hyrje në Ekonomi, fq. 254-265)</p> <p>Rëndësia e matjes së produktit të përgjithshëm dhe problemi i agregimit</p> <p>Mënyrat e matjes së produktit të përgjithshëm dhe treguesit përkatës</p> <p>Disa identitete të rëndësishme makroekonomike</p> <p>Produkti kombëtar dhe mirëqënia ekonomike</p> <p>Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.158-168)</p>
<p>Java XI. Ekuilibri makroekonomik (Hyrje në Ekonomi, fq. 266-281)</p> <p>Kërkesa agregate dhe faktorët përcaktues të saj</p> <p>Oferta agregate dhe faktorët përcaktues të saj</p> <p>Ekuilibri makroekonomik. Modeli klasik dhe ai kejnsonian</p> <p>Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.171-179)</p> <p>Konsumi dhe investimet (Hyrje në Ekonomi, fq. 282-296)</p> <p>Konsumi dhe kursimi. Të ardhurat e disponueshme dhe funksioni i konsumit</p> <p>Faktorë të tjerë përcaktues të konsumit</p> <p>Investimet dhe faktorët përcaktues të tyre</p> <p>Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.181-189)</p>
<p>Java XII. Shpenzimet dhe të ardhurat (Hyrje në Ekonomi, fq. 297-312)</p> <p>Shpenzimet agregate dhe GDP real. Investimet dhe kursimi</p> <p>Multiplikatori i shpenzimeve</p> <p>Multiplikatori i politikës fiskale</p> <p>Multiplikatori i ekonomisë së hapur</p> <p>Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.191-201)</p> <p>Ciklet e biznesit & rritja ekonomike (Hyrje në Ekonomi, fq. 313-327)</p>

<p>Ciklet e biznesit dhe fazat e tij Disa teori të ciklit të biznesit Rritja ekonomike Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.203-210)</p>
<p>Java XIII. Inflacioni (Hyrje në Ekonomi, fq. 329-337) Kuptimi i inflacionit Llojet e inflacionit Kostot e inflacionit Papunësia (Hyrje në Ekonomi, fq. 339-351) Papunësia, matja e papunësisë dhe kostot e saj Interpretimi ekonomik i papunësisë dhe llojet e saj Norma natyrore e papunësisë Raporti Inflacion - Papunësi (Hyrje në Ekonomi, fq. 353-363) Burimet e inflacionit Raporti papunësi- inflacion. Kurba e Filipsit Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.211-221)</p>
<p>Java XIV. Paraja dhe sistemi bankar (Hyrje në Ekonomi, fq. 365-377) Paraja dhe funksionet e saj Komponentët e ofertës monetare dhe kërkesa për para Bankat, llojet e tyre dhe procesi i krijimit të depozitave Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.223-229) Banka Qëndrore dhe politika monetare (Hyrje në Ekonomi, fq. 379-394) Funksionet e bankës qëndrore dhe instrumentet e politikës monetare Tregu monetar dhe mekanizmi i politikës monetare Rryma monetariste dhe veçoritë e saj Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.232-238)</p>
<p>Java XV. Politika fiskale (Hyrje në Ekonomi, fq. 395-406) Buxheti qeveritar dhe politika fiskale Ndërveprimet e politikave monetare dhe fiskale Pasojat ekonomike të borxhit qeveritar Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.240-248) Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare (Hyrje në Ekonomi, fq. 408-421) Tregtia ndërkombëtare, faktorët që e përcaktojnë dhe ekuilibri në tregun ndërkombëtar Bilanci i pagesave, tregu valutator dhe kurset e këmbimit Ushtrime (Hyrje në Ekonomi, fq.250-259)</p>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: jo më pak se 75% të orëve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Kolokuium: 15%

Detyre kursi : 5%

Diskutim në seminare: -10%

Provimi përfundimtar 70%. Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të semestrit.

LITERATURA
Literatura bazë e detyrueshme:

A. Mançellari; S. Hadëri; Dh. Kule; S. Qirici HYRJE NË EKONOMI
S.Gruda; L.Minxhozi; R. Duka; A. Hashorva Hyrje në Ekonomi (Ushtrime)

Literatura e rekomanduar:

John Maynard Keynes, The general Theori of Employment, Interest and Money
Paul Krugman, The return of depression Economics and dhe Crisis of 2008
Paul Krugman, End this Depression Now
Stephen L. Slavin Classical And Keynesian Economics
Alan S. Blinder, Afer the Music Stopped: The Financial Crisis, the Response and the Work Ahead
John Quiggin, Zombie Economics: How Dead Ideas Still Walk Among Us, (Princeton University, 2011)
Justin Fox, The Myth of the Rational Market: A history of Risk, Reward and Delusion on Wall Street (New York, 2009)
Daron Acemoglu and James Robinson, Why Nation Fail: The origins of Power, Prosperity and Poverty (New York: 2012)
Steven D. Levitt and Stephen J. Dubner, Freakonomiks: A Rogue Economist Explorer the Hidden Side of Everything (New York:, 2005)
Philip T. Hoffman, Gilles Postel-Vinay, and Jean-Laurent Rosenthal, Surviving Large Losses: Financial Crises the Middle Class and the Development of Capital Markets, (Harvard University 2009)
John J. Siegfried, Better Living Through Economics (Harvard University,
P.J. O'Rourke, On the Welth of Nations (2007)
Joseph E. Stiglitz, Making Globalization Work (New York, 2006)
Milton Friedman, Capitalism and Freedom (Chicago: University of Chicago 2002)

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>UNIKO është institucion i akredituar për një periudhë 5 vjeçare. Programet që ofrohen në fakultetin e Ekonomisë janë programe të licensuara me VKM ose Urdhër të MASR-së.</p> <p>Programet janë të organizuara në përputhje me udhëzimet e MASR-ja dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS. Ngarkesa vjetore është 60 kredite, e ndarë në mënyrë të balancuar mes dy semestrave. Programet ofrohen me kohë të plotë. Programet e studimit të Fakultetit të Ekonomisë hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të drejtimeve prioritare akademike të UK, të</p>

	përcaktuara në <i>statutin</i> e UK neni 6 pika 8 dhe referuar si fushë studimi në <i>Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë</i> neni 5 pika 5 .
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT Standardi II.4 - Programet e studimit të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programeve;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>UK vë në dispozicion për studentët kohëzgjatjen e programit të studimit Financë-Kontabilitet, studentët mund ta sigurojnë nëpërmjet dokumentave të tilla si: rregullorja e fakultetit, rregullorja e programit të studimit, fletë palosjeve dhe leksionit të hapur që zhvillohet ditën e parë të vitit akademik nga koordinatori i programit. Informacioni gjendet në arkivën e njësisë bazë dhe në faqen elektronike të UK-së.</p> <p>UK vë në dispozicion për studentët dokumentacionin / udhëzues të posaçëm për ti informuar në mënyrë të hollësishme në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Programet e lëndëve edhe ato të shkurtuara janë të publikuara në formë elektronike në sit-in e sekretarisë online si dhe në formë fizike pranë arkivës së njësisë bazë.</p> <p>Ndërkohë planet mësimore, lëndët dhe modulet e programit të studimit si dhe kurrikulat e Stafit akademik janë të publikuara në ëeb dhe gjenden të dokumentuara pranë përgjegjëses së njësisë bazë.</p> <p>Informacioni në lidhje me praktikat mësimore vihet në dispozicion studentëve të secilit program studimi.</p>
<p><u>Konkluzionet e GVB:</u></p> <p>GVB vlerëson se studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Çdo fillim viti atyre u vihet në dispozicion programi i lëndëve që ofrohen (silabuset). Këto programe afishohen nga departamenti në vende të dukshme. Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të universitetit ëëë.unkorce.edu.al Konstatohet një ndarje e balancuar e ngarkesës mësimore nëpër semestra dhe nga njëri vit në tjetrin. Lëndët gjithashtu janë të organizuara në tipologji, ku lëndët e një karakteri të mirëfilltë teorik kanë më shumë leksione në auditor, ndërsa lëndët me karakter praktik kanë ngarkesë më të lartë të orëve të seminarit dhe orëve për projekte/detyra/ushtrime. Ky organizim shërben për të rritur nivelin e mësimnxënies së studentëve, pasi lehtëson përvetësimin e informacionit, duke iu përshtatur natyrës së lëndës</p>	

8. Mësimdhënia

Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:

- a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
- b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
- c) objektivat formuese dhe kompetencat profesionale;
- ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
- d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;
- dh) planin mësimor;
- e) programin lëndor (Syllabus-et);
- ë) kreditet sipas ECTS-së

Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).

Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, performancave artistike, praktikave dhe tezave të diplomave. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formuese e të kompetencave profesionale të programit nga student. Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formuese dhe të kompetencave profesionale.

Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:

- i) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;
- ii) studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
- iii) përgatitje për provime;
- iv) përgatitje e tezës së diplomës;
- v) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private.

Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve që ka secila disiplinë.

Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u përlogaritet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS.

Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- i) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
- ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
- iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disipinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;
- iv) Lëndë plotësuese, të fokusuara në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;

Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.

Veprimtaritë formuese mund të jenë:

- i) të detyrueshme;
- ii) të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni, dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit.

Tregues të matshëm:

Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programet e studimit,

Tabela 37 Ngarkesa totale në auditor - BCH, Financë-Kontabilitet

Programi i Studimit Bachelor në Financë-Kontabilitet	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1200
Seminare	854
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Orë në auditor (leksione + seminare)	2054
Studim individual	2446
Në total	4500

Tabela 38 Ngarkesa totale në auditor - BCH në Menaxhim

Programi i Studimit Bachelor në Menaxhim	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1251
Seminare	815

Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Orë në auditor (leksione + seminare)	2066
Studim individual	2434
Në total	4500

Tabela 39 Ngarkesa totale në auditor - BCH në A.B. Marketing

Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi në Marketing	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1071
Seminare	1036
Ushtrime	
Laboratore	
Praktikë lëndore	
Praktikë profesionale	
Orë në auditor (leksione + seminare)	2107
Studim individual	2393
Në total	4500

Tabela 40 Ngarkesa totale në auditor - BCH në A.B. në Turizëm

Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi në Turizëm	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1071
Seminare	1036
Ushtrime	
Laboratore	
Praktikë lëndore	
Praktikë profesionale	
Orë në auditor (leksione + seminare)	2107
Studim individual	2393
Në total	4500

Tabela 41 Ngarkesa totale në auditor - BCH në Ekonomiks

Programi i Studimit Bachelor në Ekonomiks	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	968
Seminare	930
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Orë në auditor (leksione + seminare)	1898

Studim individual	2602
Në total	4500

Tabela 42 Ngarkesa totale në auditor - BCH në Informatikë Biznesi

Programi i Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1116
Seminare	902
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Orë në auditor (leksione + seminare)	2018
Studim individual	2482
Në total	4500

Tabela 43 Ngarkesa totale në auditor - BCH në Biznes dhe Tregëti

Programi i Studimit Bachelor në Biznes dhe tregëti	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1221
Seminare	889
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Orë në auditor (leksione + seminare)	2110
Studim individual	2390
Në total	4500

Tabela 44 Ngarkesa totale në auditor - MP në Financë-Kontabilitet

Programi i Studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet (90 kredite)	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	690
Seminare	435
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Studim individual	1150
Në total	2250
Programi i Studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet (60 kredite)	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor

Leksione	435
Seminare	195
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Studim individual	870
Në total	1500

Tabela 45 Ngarkesa totale në auditor - MP në Administrim Biznesi

Programi i Studimit Master Profesional në Administrim Biznesi (90 kredite)	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	690
Seminare	435
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Studim individual	1150
Në total	2250
Programi i Studimit Master Profesional në Administrim Biznesi (60 kredite)	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	495
Seminare	215
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Studim individual	790
Në total	1500

Tabela 46 Ngarkesa totale në auditor - MP në Marketing

Programi i Studimit Master Profesional në Marketing (90 kredite)	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	645
Seminare	455
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Studim individual	1150
Në total	2250
Programi i Studimit Master Profesional në Marketing (60 kredite)	
Format e mësimdhënies	Orët totale

	në auditor
Leksione	460
Seminare	180
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	60
Studim individual	800
Në total	1500

Tabela 47 Ngarkesa totale në auditor - MP në Turizëm

Programi i Studimit Master Profesional në Turizëm (90 kredite)	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	660
Seminare	425
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Studim individual	1150
Në total	2250
Programi i Studimit Master Profesional në Turizëm (60 kredite)	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	450
Seminare	180
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	60
Studim individual	810
Në total	1500

Tabela 48 Ngarkesa totale në auditor - MP në Bankë dhe Sigurime

Programi i Studimit Master Profesional në Bankë dhe sigurime (60 kredite)	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	407
Seminare	196
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Studim individual	897
Në total	1500

Tabela 49 Ngarkesa totale në auditor - MSH në Financë

Programi i Studimit Master Shkencor në Financë në Turizëm	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	870
Seminare	625
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Studim individual	1505
Në total	3000

Programi profesional 2-vjeçar në Asistent menaxher	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	729
Seminare	596
Ushtrime	--
Laboratore	--
Praktikë lëndore	--
Praktikë profesionale	--
Studim individual	1675
Në total	3000

Format e kontrollit të njohurive

Kontrulli i dijeve realizohet nëpërmjet testeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, performancave artistike, praktikave dhe tezave të diplomave. Kontrulli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formuese të kompetencave profesionale të programit nga studenti. Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale. Pesha e vlerësimit të vazhduar me vlerësimin përfundimtar qëndron në raportet 30% me 70%. Elementet specifike dhe pesha që zënë ato në vlerësimin e vazhduar përshkruhen në sylabuset e lëndëve nga secili pedagog dhe miratohet që në fillim të vitit nga përgjegjësi i departamentit i cili miraton këtë sylabus. Këto raporte ndryshojnë në varësi të llojit të lëndës dhe programit të studimit.

9. Studentët

Në programet e studimit, të ofruara në Fakultetin e Ekonomisë, pranojnë për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:

- Vërtetojnë me dokument zyrtar zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose të diplomës përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullores së programit të studimit përkatës.

- b. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme sipas përcaktimeve të fakultetit.
- c. Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimit të përcaktuara nga organet drejtuese të Fakultetit të Ekonomisë.
- d. Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, duhet të ndjekin procedurën e njohjes së diplomës në MASR, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- e. Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të vendosura nga SA.

Renditja e kandidatëve fitues, bazohet në Nenin 76, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe realizohet nga komisioni i ngritur pranë Departamentit.

Në Fakultetin e Ekonomisë ofrohen lloje të ndryshme bursash, si bursa sociale për shtresat në nevojë, bursa të pjesshme, bursa ekselence për studentët me rezultate të larta gjatë studimeve etj.

Në Tabela 50 paraqiten të dhëna në lidhje me numrin e studentëve të rregjistruar në vitin e parë gjatë vitit akademik 2018-2019 dhe niveli cilësor i tyre.

Tabela 50 Numri i studentëve në vitin e parë në FE, 2018-2019

Nr	PROGRAMI I STUDIMIT	APLIKIM E	PRANIME	NIVELI CILËSOR NOTA MESATARE		
				MAX	MIN	E përgjithshme
1.	Financë - Kontabilitet BA	305	65	9.83	6	*
2.	Ekonomiks BA	178	11	*	6	*
3.	Menaxhim BA	332	40	9.15	6.07	6.62
4.	Informatikë Biznesi BA	62	17	8.97	6.02	7.1
5.	Administrim Biznesi në Marketing BA	312	28	8.68	6	6.84
6.	Administrim Biznesi në Turizëm BA	391	18	8.7	6	6.6
7.	Biznes dhe Tregti BA	50	13	7.64	6.02	6.47
8.	Financë-Kontabilitet MP	34	34	9.53	5	*
9.	Bankë dhe Sigurime	13	13	7.03	5	*
10.	Administrim Biznesi MP	21	21	7	5	5.65
11.	Marketing MP	14	14	8	5.1	6.71
12.	Turizëm MP	12	12	8	5	6.54
13.	Asistent Menaxher PP	186	47	**	**	**
	TOTALI PRANIMEVE		333			

* Pa plotësuar nga Departamenti Financë – Kontabilitet
 ** Pa plotësuar nga Departamenti Menaxhim

Në Tabela 51 paraqitet numri i studentëve për të gjitha programet e studimit që janë ofruar në Fakultetin e Ekonomisë gjatë vitit akademik 2018 – 2019 (cikli i parë, i dytë dhe program profesional).

Tabela 51 Numri i studentëve për të gjitha programet e studimit, 2018-2019

	PROGRAMI I STUDIMIT	BA/MP/MSc/ PP	VITI I		VITI II		VITI III		GJITHSEJ		GJITHSEJ
			F	M	F	M	F	M	F	M	
1	Financë-Kontabilitet	BA	40	25	39	33	85	50	164	108	272
2	Ekonomiks	BA	9	2	-	-	-	-	9	2	11
3	Menaxhim	BA	21	20	22	26	49	56	92	102	194
4	Informatikë Biznesi	BA	8	9	-	-	-	-	8	9	17
5	Administrim Biznesi në Marketing	BA	19	12	9	14	19	9	47	35	82
6	Administrim Biznesi në Turizëm	BA	11	10	10	12	23	23	44	45	89
7	Biznes dhe Tregti	BA	8	5	-	-	-	-	8	5	13
Totali			116	83	80	85	176	138	372	306	678
8	Financë-Kontabilitet	MP _(60 kredite)	26	8					26	8	34
9	Financë-Kontabilitet	MP _(90 kredite)			30	22			30	22	52
10	Bankë dhe Sigurime	MP _(60 kredite)	11	2					11	2	13
11	Administrim Biznesi	MP _(60 kredite)	7	14					7	14	21
12	Administrim Biznesi	MP _(90 kredite)			15	22			15	22	37
13	Marketing	MP _(60 kredite)	4	10					4	10	14
14	Marketing	MP _(90 kredite)			2	14			2	14	16
15	Turizëm	MP _(60 kredite)	4	7					4	7	11
16	Turizëm	MP _(90 kredite)			5	17			5	17	22
Totali			52	41	52	75			104	116	220
17	Financë	MSc	-	-	6	-			6	-	6
18	Asistent Menaxher	PP	11	36	-	-			11	36	47
TOTALI			179	160	138	160	176	138	493	458	951

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007,	Dispozitat e Ligjit 80/2015 janë baza ku mbështeten tërësisht procedurat dhe politikat që lidhen me studimet në UK. Statuti i UK, neni 50 përcakton që pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, bëhet sipas kuotave të paracaktuara dhe është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson:

<p>“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për prazgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>-Kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>- Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, si dhe gruplëndët, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në UK) sipas përcaktimeve të njësisive bazë.</p> <p>Procedurat dhe rregullat që lidhen me ecurinë e ciklit të plotë akademik të studentëve për programet që mbulon Fakulteti Ekonomik (FE) janë të reflektuara në Rregulloren e Brendshme të FE-së. Në këtë rregullore specifikohen gjithashtu edhe rregullat e regjistrimit të studentëve, hartimit të planeve mësimore, struktura e vitit akademik, zhvillimit të provimeve, përgatitjes dhe shpërndarjes së diplomave etj. Sekretaria e ZIS (zyra e Informimit të studentëve) dhe sekretaria mësimore kontrollon dhe mbikqyr në mënyrë të vazhdueshme, zbatimin korrekt të këtyre rregullave. Mbështetur në kërkesat e ligjit 80/2015, rregullorja e programit të studimit përcakton gjithashtu edhe procedurat e tërheqjes së diplomës.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentëve u jepet informacion i gjerë dhe i detajuar mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Organizimin e procesit mësimor dhe strukturën mësimore të vitit akademik dhe sezonin e provimeve, nëpërmjet orarit mësimor dhe grafikut të provimeve , të cilët vendosen në stendat e mjediseve të FE, si edhe në ëeb-in e UK-së dhe FE-së. Aty pasqyrohen të ndara lëndët sipas viteve akademike të shoqëruara me sallën dhe lektorin ose pedagogun përkatës. 2. Infrastrukturën nëpërmjet tabelave orientuese që janë vendosur në zona të ndryshme të qytetit dhe pranë godinave të kampuseve universitare. Për orientim më të detajuar janë vendosur emërtime dhe numeracion tek godinat dhe sallat ku zhvillohet procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera akademike. 3-Shërbimet universitare dhe fasilite të tjera si kujdestari dhe këshillim për studentët në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe veprimtarive akademike të cilat janë përcaktuar në Rregulloren e Studimeve të UK. Këto shërbime ofrohen nga strukturat përkatëse të tilla si: Sekretaritë mësimore, ZIS dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni. <p>Në nivel njësie bazë, studentët këshillohen, orientohen dhe ndihmohen prej sekretares së departamentit dhe stafit akademik.UK informon dhe mbështet studentët për mundësitë e punësimit dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Qendra e Karrierës dhe Alumnit e ngritur pranë UK është ajo që krijon lidhjen midis studentit, departamentit Financë-Kontabilitet dhe tregut të punës dhe inkurajon studentët të planifikojnë karrierën e tyre përmes trajnimeve, forumeve, seminareve dhe takimeve individuale me studentët.</p>

	<p>QKA zhvillon "Modulin e Karrierës", i cili është një cikël informacionesh që i përgatit studentët për tregun e punës. Moduli i Karrierës përfshin :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Shkrimi i Curriculum Vitae(CV) -Shkrimi i letrës së interesit -Shkrimi i projekteve -Shkrimi i temës së diplomës -Mënyra e citimeve në punimet shkencore -Këshilla studentëve për "Intervistën e Punës" <p>Ato zhvillohen në grupe me jo më shumë se 10 studentë.</p> <p>Studentët kanë mundësi për të bërë vlerësimin e pedagogëve për çdo element të cilësisë së mësimdhënies, komunikimit etj, nëpërmjet pyëtësorit studentor që zhvillohet në mënyrë anonime dhe online prej tyre sipas një kalendari veprimtarish. Studentët bëhen pjesë e takimeve informuese nga ASCAL lidhur me sondazhin kombëtar të studentëve.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin Programet e studimit të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në Programet e studimit të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programeve apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programeve të</p>	<p>UK për disponimin dhe mbajtjen e statistikave vjetore për studentët që nga rregjistrimi deri në diplomim mbështetet në statut Neni 71 sipas të cilit, UK-ja detyrohet të mbajë në formë të shkruar në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, « Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë»:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin themeltar të studentëve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në UK. Ai plotësohet edhe në formë elektronike (Rregullore e Sekretarisë, neni 13). - Regjistrin e arritjeve akademike, që është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në UK, sipas programeve të studimit. Ky plotësohet edhe në formë elektronike. - Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, që është dokumenti që vërteton emetimin e tyre prej UK-së, i cili plotësohet edhe në formë elektronike. <p>-Sekretaria mësimore disponon edhe një rregjistër të rregjistrimit paraprak studentëve që përdoret deri në rregjistrimin final të studentëve fitues të UK-së. Gjithashtu, rregullorja e sekretarisë për regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin përcakton mbajtjen e statistikave vjetore për të diplomuarit si dhe plotësimin në kohë dhe me cilësi të të gjitha dokumentacioneve të mësipërme. Përsa i përket të diplomuarve, rrjeti ALUMNI i universitetit përditëson të dhënat mujore nëpërmjet gjurmimit të tyre me telefon, email, ose formularë të shpërndarë në terren, me qëllim jo vetëm sigurimin e informacionit por edhe për të shkëmbyer përvojat më të mira në fushën e arsimimit dhe punësimit.</p> <p>Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, të tërhequr apo të larguar para përfundimit të programit të studimit disponohen nga sekretaria mësimore dhe në bazën e të dhënave të sistemit ESSE3. Ndërkohë menaxhimin</p>

<p>studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>e këtyre ë dhënavë e kryen Zyra e Statistikës pranë Sektorit të Projekteve Kërkimit Shkencor dhe Dixhitalizimit (SPKSHD). Gjithë dokumentacioni ruhet në regjistrat e sekretarisë mësimore pranë FE, në sistemin ESSE3 dhe pasqyrohet i përpunuar në mënyrë të detajuar në raportin vjetor të analizës mësimore dhe kërkimore të njësisë kryesore.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor; Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumnit e ngritur pranë UK është ajo që krijon lidhjen midis studentit, departamentit Financë-Kontabilitet dhe tregut të punës dhe inkurajon studentët të planifikojnë karrierën e tyre përmes trajnimeve, forumeve, seminareve dhe takimeve individuale me studentët. QKA zhvillon "Modulin e Karrierës", i cili është një cikël informacionesh që i përgatit studentët për tregun e punës. Moduli i Karrierës përfshin : -Shkrimi i Curriculum Vitae(CV) -Shkrim i letrës së interesit -Shkrimi i projekteve -Shkrimi i temës së diplomës -Mënyra e citimeve në punimet shkencore -Këshilla studentëve për “Intervistën e Punës” Ato zhvillohen në grupe me jo më shumë se 10 studentë.</p>
<p><u>Konkluzionet e GVB</u></p> <p>GVB vlerëson se studentët janë në qëndër të të gjithë aktiviteteve të Fakultetit të Ekonomisë nga momenti i regjistrimit, në diplomimin dhe punësimin e tij. Krahas formimit dhe këshillimit që ofrohet nga personeli akademik i Fakultetit të Ekonomisë, studentët mund t’i drejtohen edhe Qendrës së Karrierës dhe Alumni, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore në kuadrin e UNIKO-së. Vëmendje e veçantë i kushtohet mendimit dhe kërkesave të studentëve ekselentë, me të cilët janë zhvilluar vazhdimisht tryeza të rrumbullakta dhe grupe fokus për të marrë informacion në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor në funksion të programeve të studimit

Misioni i UNIKO i përcaktuar edhe në statutin e tij e vë theksin në krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Ky mision realizohet ndër të tjera edhe nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave, parimeve dhe procedurave të cilat mbikëqyrin procesin e mbështetjes financiare dhe logjistike që UNIKO ofron për njësitë e saj akademike dhe ndihmësakademike. Për këtë arsye, synimi kryesor i strukturave mbështetëse për kërkimin shkencor në UNIKO është përqendruar në ndërtimin e mekanizmave kërkimore institucionale të lidhur me programe të përcaktuara mirë, prioritet të qarta dhe me ofrimin e shpërblimeve dhe vlerësimeve si nxitës për përfshirjen e stafit akademik në veprimtari kërkimore-zhvillimore cilësore, pa lënë mënjanë elemente të produktit shkencor, publikimet, partneritetet, marketingun kërkimor dhe ofrimin e shërbimeve për të tretë, për ta ngritur Kërkimin shkencor në UNIKO të përafrueshëm me standardet e përcaktuara në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor.

Theksi është vendosur gjithashtu edhe në nxitjen e hapjes shkencore përmes organizimit të veprimtarive periodike, konferencave shkencore, posterave promocoinalë, duke rritur kërkimin ndërdisiplinor dhe bashkëpunues, si dhe duke ju përafruar standardeve të cilësisë në rritjen e kulturës kërkimore për të shkuar drejt krijimit të qendrave kërkimore. Po kështu, një masë tjetër për realizimin e objektivave systrategjikë është edhe ngritja e Qendrës së Inovacionit duke hedhur bazat për inovacionin shkencor, gjurmimin e ideve të reja, teknologjive bashkëkohore, spin-off me shtrirje të madhe dhe prirje për t'u lidhur me industrinë dhe marketingun kërkimor.

UNIKO dëshiron të përhapë mesazhin e rritjes akademike dhe cilësisë së kërkimit shkencor. Për realizimin e këtij misioni janë hartuar objektiva të cilët përcaktojnë synimet e UNIKO për mbështetjen e zhvillimit sistematik të veprimtarisë kërkimore-shkencore për periudhën 2018-2020.

Objektivi 1: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore-shkencore në Universitetin e Korçës.

Objektivi 2: Përmirësimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore dhe për ofrimin e shërbimeve

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi dhe rajonalizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore duke nxitur cilësinë në kërkime.

Objektivi 4: Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Për vitin akademik 2018-2019 konstatohet një rritje e ndjeshme e pjesëmarrjes me kumtesa apo referime në konferenca shkencore ndërkombëtare apo seminare. Gjithashtu, rritje e ndjeshme vihet re edhe në numrin e artikujve shkencorë të botuar në nivel Fakulteti, krahasuar me vitet e kaluara.

Tabela 52 Numri i pjesëmarrësve në veprimtari shkencore dhe botuese, 2018-2019

FAKULTETI I EKONOMISË					
Konferenca Ndërkombëtare	Lektorium	Workshop	Seminar	Tekste	Artikuj
20	1	5	12	3	32

Fakulteti e ka realizuar objektivin për botimin e revistës “Studime Ekonomike” Vol. 1 (1) - 2019, botim i Fakultetit të Ekonomisë.

“Studime Ekonomike” është një revistë e re e ekonomisë dhe e disiplinave të lidhura me të, e cila synon të promovojë punime që mund të kontribuojnë në zhvillimin e teorisë dhe praktikës në fushën e shkencave ekonomike.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programeve, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Administrimi i programeve të studimit realizohet kryesisht nëpërmjet rregulloreve të brendshme, siç është rregullorja e studimeve e UNIKO, Rregullore e FE , Rregullore e njësisë bazë dhe rregullore e programit të studimit. Këto rregullore mbështeten në Ligjin për Arsimin e Lartë si dhe Statutin e UK . Dokumente të tjera që përmbajnë elementë të përgjegjësiive respektive dhe analizës së punës janë vendimet e rektoratit .</p> <p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p>	<p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale, UK, FE dhe departamentet kane lidhur marrëveshje bashkëpunimi më shumë institucione publike dhe kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione. Specifikat e organizimit të praktikës mesimore jepen tek Udhëzuesit për Praktikën.</p> <p>Mbas përfundimit të praktikës komisioni i cili vlerëson studentet paraqet një raport mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione dhe biznese për zhvillimin e praktikës. Gjithashtu në kuadër të këtyre marrëveshjeve janë organizuar në mënyrë permanente leksione të hapura e tryeza të rumbullakta me përfaqesues të bizneseve, institucioneve publike, etj.</p>

<p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	
<p><u>Konkluzionet e GVB</u></p> <p>Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, FE nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit dhe siguron një përfshirje më të gjerë. Fakulteti i Ekonomisë organizon takime formale dhe jo formale me anëtarët e departamenteve pjesë e së cilës janë dhe analizat. FE përfundon realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj. Institucioni ka bërë pjesë të analizave të tij dhe ecurinë e këtyre marrëveshjeve.</p>	

ANALIZA SWOT

a. Pika të forta:

- FE mbështetet në një vizion të mirë përcaktuar, mision dhe plan të zhvillimit strategjik të qartë, të plotë, bashkëkohor. Dokumenti i Planit Strategjik të Zhvillimit të institucionit është një dokument që orienton drejt dhe me realizëm zhvillimin në kontekstin e institucionit, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.
- Programet janë ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin e institucionit, nevojat e tregut.
- Programe akademike bashkëkohore. Kurrikula të veçanta në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit.
- Shkalla e lartë e kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik të brendshëm të fakultetit dhe atij mbështetës.
- Respektimi i standardeve akademike. Programet e studimit respektojnë standardet akademike. Plani mësimor, syllabuset, metodat e mësimdhënies e mësimnxënies janë sipas kërkesave të standardeve akademike.
- Përdorimi me efektivitet i pajisjeve audiovizive për zhvillimin e mësimin dhe të veprimtarive të tjera, si dhe internet 24 orë.
- Ambjente dhe laboratorë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e orëve të mësimin.
- Zhvillimi i programeve të nivelit të dytë Master Profesional dhe Shkencor.
- Lidhjet e ngushta të Fakultetit tonë me fakultetet homologe brenda dhe jashtë vendit.
- Pjesëmarrja e gjerë e stafit të Fakultetit në konferenca kombëtare e ndërkombëtare.

- Bashkepunimi i ngushtë i anëtarëve të fakultetit në botime artikujsh shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
- Preference e lartë nga maturanet për programet e studimit të fakultetit ekonomik.
- Marrëdhënie të mira me studentët.

b. Pika të dobëta:

- Numri i studentëve jo në nivelet e planifikuara
- Cilësia relativisht e dobët e studentëve në hyrje për disa programe studimi.
- Përdorimi joeficient i burimeve të bibliotekës.
- Mungesa e mundësive për të krijuar lidhje të mira të teorisë me praktikën për pajisur studentët me aftësi praktike.
- Pjesëmarrje e ulët në projekte

c. Mundësitë

- Eksperienca dhe kualifikimet e stafit akademik rrit mundësinë për të aplikuar dhe bërë pjesë e projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare prej të cilave mund të përfitojnë direkt dhe/ose indirekt studentët.
- Miratimi i programeve të nivelit të dytë.
- Shanse për rritjen e bashkëpunimit të Fakultetit me biznesin rajonal.
- Kthimi i fakultetit në një qendër trajnimi me njohuri ekonomike në rajonin juglindor të vendit.
- Pozita e favorshme gjeografike e rajonit për tërheqjen e studentëve edhe nga vendet kufitare për programe të ndryshme studimi.
- Mundësi punësimi si rezultat i rritjes të kërkesës të tregut për profesionin e ekonomistit.

d. Pengesat

- Hapje të programeve të reja në njësitë e tjera kryesore të Universitetit
- Hapja e programeve të reja në Universitetet e tjera
- Faktorët demografikë të cilët projektojnë në të ardhmen një vijim të rënies së numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin parauniversitar.
- Vështirësi në rekrutimin e një stafi të kualifikuar
- Vendimmarrje e centralizuar